



www.qbz.gov.al

FLETORJA ZYRTARE E REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Botim i Qendrës së Botimeve Zyrtare

Viti: 2019 – Numri: 163

Tiranë – E martë, 3 dhjetor 2019

PËRMBAJTJA

	Faqe
Akt normativ i Këshillit të Ministrave nr. 6, datë 30.11.2019	Për dhurimin e apartamenteve familjarëve të viktimave, si pasojë e tërmetit të datës 26.11.2019..... 12925
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 753, datë 30.11.2019	Për përkrahjen sociale dhe financiare të familjeve të viktimave të tërmetit të datës 26.11.2019..... 12926
Vendim i Entit Rregullator i Sektorit të Furnizimit me Ujë dhe Largimit e Përpunimit të Ujërave të Ndotura nr. 43, datë 20.9.2019	Për licencimin e shoqërisë Ujësjiellës-Kanalizime Himarë sh.a..... 12926
Vendim i Entit Rregullator i Sektorit të Furnizimit me Ujë dhe Largimit e Përpunimit të Ujërave të Ndotura nr. 44, datë 20.9.2019	Për një ndryshim në vendimin e Komisionit Kombëtar Rregullator nr. 47, datë 13.6.2018, “Për licencimin e sh.a. Ujësjiellës-Kanalizime Dibër” 12927
Vendim i Entit Rregullator i Sektorit të Furnizimit me Ujë dhe Largimit e Përpunimit të Ujërave të Ndotura nr. 48, datë 10.10.2019	Për miratimin e tarifave të shërbimit të furnizimit me ujë dhe largimin e ujërave të ndotura për shoqërinë Ujësjiellës-Kanalizime Berat–Kuçovë sh.a. 12928
Vendim i Entit Rregullator i Sektorit të Furnizimit me Ujë dhe Largimit e Përpunimit të Ujërave të Ndotura nr. 51, datë 28.10.2019	Për miratimin e tarifave të shërbimit të furnizimit me ujë dhe largimin e ujërave të ndotura për shoqërinë Ujësjiellës-Kanalizime Vlorë sh.a. 12933
Vendim i Entit Rregullator i Sektorit të Furnizimit me Ujë dhe Largimit e Përpunimit të Ujërave të Ndotura nr. 52, datë 28.10.2019	Për miratimin e tarifave të shërbimit të furnizimit me ujë dhe largimin e ujërave të ndotura për shoqërinë Ujësjiellës-Kanalizime Krujë sh.a. 12937
Vendim i Entit Rregullator i Sektorit të Furnizimit me Ujë dhe Largimit e Përpunimit të Ujërave të Ndotura nr. 53, datë 28.10.2019	Për miratimin e tarifave të shërbimit të furnizimit me ujë dhe largimin e ujërave të ndotura për shoqërinë Ujësjiellës-Kanalizime Himarë sh.a. 12941

Vendim i Entit Rregullator i Sektorit të Furnizimit me Ujë dhe Largimit e Përpunimit të Ujërave të Ndotura nr. 54, datë 28.10.2019	Për një ndryshim në vendimin e Komisionit Kombëtar Rregullator nr. 47, datë 13.6.2018, “Për licencimin e sh.a. Ujësjetllës-Kanalizime Dibër”, i ndryshuar.....	12945
Vendim i Entit Rregullator i Sektorit të Furnizimit me Ujë dhe Largimit e Përpunimit të Ujërave të Ndotura nr. 55, datë 28.10.2019	Për licencimin e shoqërisë Ujësjetllës-Kanalizime Elbasan sh.a.....	12946
Vendim i Entit Rregullator i Sektorit të Furnizimit me Ujë dhe Largimit e Përpunimit të Ujërave të Ndotura nr. 56, datë 28.10.2019	Për licencimin për herë të parë të shoqërisë Ujësjetllës-Kanalizime Këlcyrë sh.a.	12947
Vendim i Entit Rregullator i Sektorit të Furnizimit me Ujë dhe Largimit e Përpunimit të Ujërave të Ndotura nr. 57, datë 28.10.2019	Për një ndryshim në vendimin e Komisionit Kombëtar Rregullator nr. 6, datë 3.2.2017, “Për licencimin e sh.a. Ujësjetllës-Kanalizime Gjirrokastër”	12949
Njoftim i Ministrisë për Evropën dhe Punët e Jashtme nr. 16979, datë 25.11.2019	Mbi aderimin e Republikës së Shqipërisë në një konventë.....	12950



AKT NORMATIV
Nr. 6, datë 30.11.2019

PËR DHURIMIN E APARTAMENTEVE
FAMILJARËVE TË VIKTIMAVE, SI
PASOJË E TËRMETIT TË DATËS
26.11.2019

Në mbështetje të nenit 101 të Kushtetutës, me propozimin e ministrit të Financave dhe Ekonomisë dhe të ministrit të Brendshëm, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

Neni 1

Dhurimin e 17 apartamenteve, në pronësi të Bashkisë Tiranë, të ndodhura në Njësine Administrative nr. 1, Tiranë, për familjarët e viktimave, si pasojë e tërmetit të datës 26.11.2019.

Njësitë e vetëqeverisjes vendore dhurojnë në favor të familjarëve të viktimave, si pasojë e tërmetit të datës 26.11.2019 edhe apartamente nga fondi publik i banesave sociale, të përfituara sipas ligjit nr. 22/2018, “Për strehimin social”.

Neni 2

Këshilli Bashkiak Tiranë ose i njësisë përkatëse të vetëqeverisjes vendore jep pëlqimin për tjetërsimin e këtyre pasurive të paluajtshme në favor të familjarëve të viktimave të shkaktuara nga tërmeti i datës 26.11.2019, sipas parashikimeve të ligjit nr. 139/2015, “Për vetëqeverisjen vendore”, të ndryshuar.

Apartamentet që dhurohen për familjarët e viktimave, si pasojë e tërmetit të datës 26.11.2019, hiqen nga lista e pasurive të paluajtshme të Bashkisë Tiranë ose të njësisë përkatëse të vetëqeverisjes vendore.

Neni 3

1. Pavarësisht parashikimeve të ligjit nr. 107/2014, “Për planifikimin dhe zhvillimin e territorit”, të ndryshuar, dhe të vendimit nr. 408, datë 13.5.2015, të Këshillit të Ministrave, “Për miratimin e rregullores së zhvillimit të territorit”, të ndryshuar, Bashkia Tiranë, brenda 2 (dy) ditëve pune, lëshon certifikatën e përdorimit për objektet

e përcaktuara në nenin 1 të këtij akti normativ sipas gjendjes dhe dokumentacionit ekzistues të objektit.

2. Pavarësisht parashikimeve të ligjit nr. 111/2018, “Për kadastrën”, përjashtimisht sipas parashikimeve të këtij akti normativ, Agjencia Shtetërore e Kadastrës kryen fillimisht regjistrimin e apartamenteve që do të dhurohen në regjistrat e pasurive të paluajtshme në emër të Bashkisë Tiranë dhe më pas kryen veprimet e nevojshme për kalimin dhe regjistrimin e tyre në pronësi të familjarëve të viktimave të shkaktuara nga tërmeti i datës 26.11.2011.

3. Dhurimi të realizohet nëpërmjet kontratës së dhurimit, sipas parashikimeve të Kodit Civil.

4. Kontrata nënshkruhet nga kryetari i Bashkisë Tiranë ose i njësisë përkatëse të vetëqeverisjes vendore dhe nga përfaqësuesit e familjeve përfituese, të përcaktuara në listën e dërguar nga Komiteti Ndërministror i Emergjencave Civile.

5. Apartamenti i dhuruar regjistrohet në bashkëpronësi të të gjithë anëtarëve të familjes përfituese.

6. Çdo shpenzim procedural, për kryerjen e transaksioneve për dhurimin e pasurisë, paguhet nga Bashkia Tiranë ose nga njësia përkatëse e vetëqeverisjes vendore.

Neni 4

Strukturat shtetërore të vendosin në dispozicion të gjitha burimet njerëzore dhe mjetet logjistike të nevojshme që nevojiten për transferimin e këtyre familjeve në banesat e reja në Tiranë. Të gjitha shpenzimet e mobilimit dhe të pajisjeve elektroshtëpiake për këto apartamente mbulohen nga buxheti i shtetit.

Neni 5

Ngarkohen kryetari i Bashkisë Tiranë, Agjencia Shtetërore e Kadastrës dhe kryetarët e njësive të vetëqeverisjes vendore, ku është shpallur gjendja e fatkeqësisë natyrore, për zbatimin e këtij akti normativ.

Neni 6

Ky akt normativ hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTËR
Edi Rama



VENDIM
Nr. 753, datë 30.11.2019

**PËR PËRKRAHJEN SOCIALE DHE
FINANCIARE TË FAMILJEVE TË
VIKTIMAVE TË TËRMETIT TË DATËS
26.11.2019**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të pikës 5, të nenit 41, të ligjit nr. 45/2019, “Për mbrojtjen civile”, të ligjit nr. 9936, datë 26.6.2008, “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, dhe të ligjit nr. 99/2018, “Për buxhetin e vitit 2019”, të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale dhe të ministrit të Financave dhe Ekonomisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Secilës prej familjeve të viktimave të tërmetit të datës 26.11.2019 t’i akordohet shuma prej 1 000 000 (një milion) lekësh, në formën e ndihmës financiare.

2. Shpenzimet e varrimit e të ceremonisë mortore, për të gjitha viktimat e tërmetit të datës 26.11.2019, të përballohen nga buxheti i shtetit.

3. Efekti financiar përballohet nga buxheti i miratuar për vitin 2019 për Ministrinë e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale.

4. Ngarkohen Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale dhe Ministria e Financave dhe Ekonomisë për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTËR
Edi Rama

VENDIM
Nr. 43, datë 20.9.2019

**PËR LICENCIMIN E SHOQËRISË
UJËSJELLËS-KANALIZIME
HIMARË SHA**

Në mbështetje të neneve 13, 14, 15, 16 dhe 17, të ligjit nr. 8102, datë 28.3.1996 “Për kuadrin rregullator të sektorit të furnizimit me ujë dhe largimit e përpunimit të ujërave të ndotura”, i

ndryshuar (ligji nr. 8102), VKM nr. 958, datë 6.5.2009 “Për miratimin e kategorive të licencimit dhe të procedurave për aplikim për licence” (VKM nr. 958), si dhe vendimit të Komisionit Kombëtar Rregullator nr. 29, datë 8.12.2009 “Për procedurat e dhënies dhe rinovimit të licencave profesionale për subjektet juridike e fizike që ushtrojnë veprimtari në sektorin e furnizimit me ujë dhe largimit e përpunimit të ujërave të ndotura”, e ndryshuar (rregullore e licencimit),

Komisioni Kombëtar Rregullator,

në mbledhjen e datës 20.9.2019, pasi shqyrtoi çështjen me objekt: “Mbi miratimin e projektvendimit ‘Për licencimin e shoqërisë Ujësjiellës-Kanalizime Himarë sh.a.’”,

VËREN SE:

1. Shoqëria Ujësjiellës-Kanalizime Himarë (UK Himarë), me shkresën nr. 334 prot., datë 28.8.2019 ka paraqitur pranë Entit Rregullator të Sektorit të Furnizimit me Ujë dhe Largimit e Përpunimit të Ujërave të Ndotura (ERRU) kërkesën për licencim për shkak të mbarimit të afatit.

2. Komisioni Kombëtar Rregullator (KKRR) e gjeti paraqitjen e kërkesës për licencim për shkak të mbarimit të afatit të UK Himarë në konformitet me kriteret dhe procedurën e parashikuar në VKM-në nr. 958 dhe në rregulloren e licencimit.

3. Referuar kërkesës dhe dokumentacionit shoqërues, rezulton:

a) Shoqëria UK Himarë ofron shërbimin e furnizimit me ujë dhe largimin e ujërave të ndotura për 20 852 banorë të Bashkisë Himarë, si më poshtë:

- Zona e shërbimit me furnizim me ujë dhe kanalizime nga shoqëria UK Himarë

Nr.	Njësitë administrative të Bashkisë Himarë	Popullsia në juridiksion	Popullsia e shërbyer
1	Himarë	13 488	12 089
2	Lukovë	9 477	8 763
3	Horë-Vranisht	3 697	0
TOTALI		26 662 banorë	20 852 banorë

Shënim. UK Himarë nuk ofron shërbim në Njësinë Administrative Horë-Vranisht.



b) Drejtuese teknike e shoqërisë, znj. Fabjola Duro, zotëron diplomë master në “Inxhinieri mjedisi”, profili “Trajtim uji”, datë 7.12.2018.

4. ERRU-ja, në vlerësimin e kërkesës për licencim për shkak të mbarimit të afatit, ka marrë në konsideratë përmbushjen nga ana e UK Himarë, të:

a) kërkesave të ligjit nr. 8102, si dhe kuadrit rregullator në fuqi, në mënyrë të veçantë plotësimin e kushteve si aftësi teknike-profesionale, aftësi financiare të nevojshme për të përmbushur funksionet dhe për të plotësuar kushtet e licencës, përvojën në sektorin e ujësjellësve dhe kanalizimeve të mjaftueshme për të marrë përsipër detyrimet që ka licenca, si dhe mbrojtjen e interesave të konsumatorëve në lidhje me cilësinë, eficiencën, vazhdueshmërinë dhe garancinë e shërbimit;

a) kërkesave të ligjit nr. 9121, datë 28.7.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës”, të ndryshuar (ligji nr. 9121) për moslejimin e abuzimit me pozitën dominuese në treg të ndërmarrjes veçanërisht në lidhje me kufizimin e tregjeve;

c) ERRU-ja, në bazë të vlerësimit dhe verifikimeve të kërkesës së shoqërisë UK Himarë rekomandon:

- Shoqëria UK Himarë duhet të punojë në drejtim të zgjerimit të zonës së shërbimit në të gjithë Bashkinë Himarë.

Për gjithë sa më sipër, Komisioni Kombëtar Rregullator, pasi arriti në përfundimin se kërkesa e UK Himarë është e bazuar ligjërisht dhe plotëson kërkesat ligjore të parashikuara në kuadrin rregullator në fuqi,

VENDOSI:

1. Licencimin e shoqërisë Ujësjellës-Kanalizime Himarë sh.a., me NUIS L26328203D, në kategoritë:

a) kategoria A – për grumbullimin dhe shpërndarjen e ujit për konsum publik;

b) kategoria C – për largimin e ujërave të ndotura.

2. Shoqëria Ujësjellës-Kanalizime Himarë sh.a. autorizohet të kryejë veprimtaritë e licencuara me:

a) drejtues ligjor – Andrea Goro;

b) drejtuese teknike – Fabjola Çaushaj (Duro).

3. Zona e shërbimit të shoqërisë Ujësjellës-Kanalizime Himarë sh.a. është:

Bashkia Himarë: njësitë administrative: Himarë; Lukovë.

4. Kjo licencë është e vlefshme për një periudhë 4-vjeçare.

5. Drejtuesi ligjor i shoqërisë Ujësjellës-Kanalizime Himarë sh.a. detyrohet të nënshkruajë kushtet e licencës brenda 10 ditëve nga data e njoftimit.

6. Ngarkohet Drejtoria Tekniko-Ekonomike të njoftojë shoqërinë Ujësjellës-Kanalizime Himarë sh.a., për marrjen e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Ky vendim publikohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETAR
Ndrëçim Shani

VENDIM

Nr. 44, datë 20.9.2019

PËR NJË NDRYSHIM NË VENDIMIN E KOMISIONIT KOMBËTAR RREGULLATOR NR. 47, DATË 13.6.2018, “PËR LICENCIMIN E SHA UJËSJELLËS- KANALIZIME DIBËR”

Në mbështetje të neneve 13, 14, 16 dhe 17, të ligjit nr. 8102, datë 28.3.1996 “Për kuadrin rregullator të sektorit të furnizimit me ujë dhe largimit e përpunimit të ujërave të ndotura”, i ndryshuar (ligji nr. 8102), VKM-së nr. 958, datë 6.5.2009 “Për miratimin e kategorive të licencimit dhe të procedurave për aplikim për licencë” (VKM-ja nr. 958), si dhe vendimit të Komisionit Kombëtar Rregullator nr. 29, datë 8.12.2009 “Për procedurat e dhënies dhe rinovimit të licencave profesionale për subjektet juridike e fizike që ushtrojnë veprimtari në sektorin e furnizimit me ujë dhe largimit e përpunimit të ujërave të ndotura”, e ndryshuar (rregullorja e licencimit),

Komisioni Kombëtar Rregullator,

në mbledhjen e datës 20.9.2019, pasi shqyrtoi çështjen me objekt: “Mbi miratimin e projekt vendimit Për një ndryshim në vendimin e Komisionit Kombëtar nr. 47, datë 13.6.2018 Për licencimin e sh.a. Ujësjellës-Kanalizime Dibër”,”



VËREN SE:

1. Shoqëria Ujësjiellës-Kanalizime Dibër (UK Dibër), me shkresën nr. 454 prot., datë 16.7.2019, me lëndë “Njoftim në lidhje me ndryshimin e drejtuesit ligjor të sh.a. Ujësjiellës-Kanalizime Dibër”, ka paraqitur pranë Entit Rregullator të Sektorit të Furnizimit me Ujë dhe Largimit e Përpunimit të Ujërave të Ndotura (ERRU) kërkesën për rinovim të licencës për efekt të ndryshimit të drejtuesit ligjor, të shoqëruar me dokumentacionin sipas përcaktimeve të parashikuara në VKM nr. 958 dhe rregullores së licencimit.

2. Komisioni Kombëtar Rregullator (KKRR) e gjeti paraqitjen e kërkesës së UK Dibër për rinovim licence, për efekt të ndryshimit të drejtuesit ligjor në konformitet me kriteret dhe me procedurën e parashikuar në VKM-në nr. 958 dhe në rregulloren e licencimit.

3. KKRR-ja ka licencuar shoqërinë UK Dibër, me vendimin nr. 47, datë 13.6.2018 “Për licencimin e sh.a. Ujësjiellës-Kanalizime Dibër”, me një afat 4-vjeçar, ku shoqëria autorizohet të ofrojë shërbimin e grumbullimit dhe të shpërndarjes së ujit për konsum publik, si dhe largimit të ujërave të ndotura.

4. Drejtuesi ligjor i shoqërisë UK Dibër sh.a., z. Bedri Kamberi, ka mbaruar studimet e larta në Agronomi dhe Bio-Kimi dhe ka shërbyer edhe më parë si drejtues ligjor i kësaj shoqërie nga viti 2012 deri në vitin 2015.

5. ERRU-ja, në vlerësimin e kërkesës për ndryshimin e licencës, për efekt të ndryshimit të drejtuesit ligjor, ka marrë në konsideratë përmbushjen nga ana e UK Dibër sh.a. të kërkesave të ligjit nr. 8102, të VKM-së nr. 958 dhe të rregullores së licencimit, në mënyrë të veçantë sa i takon garantimit që i licencuari të veprojë në përputhje me kushtet e licencës së tij dhe të mbrojë interesat e konsumatorëve në lidhje me cilësinë, eficiencën, vazhdueshmërinë dhe garancinë e shërbimit.

Për gjithë sa më sipër, Komisioni Kombëtar Rregullator, pasi arriti në përfundimin se aplikimi i UK Dibër është i bazuar ligjërisht dhe plotëson kërkesat ligjore të parashikuara në kuadrin rregullator në fuqi,

VENDOSI:

1. Në pikën 1 të vendimit të KKRR-së nr. 47, datë 13.6.2018 “Për licencimin e sh.a. Ujësjiellës-Kanalizime Dibër”, bëhen këto ndryshime:

“Drejtues ligjor z. Bedri Kamberi”.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Ky vendim publikohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETAR
Ndriçim Shani

VENDIM

Nr. 48, datë 10.10.2019

**PËR MIRATIMIN E TARIFAVE TË
SHËRBIMIT TË FURNIZIMIT ME UJË
DHE LARGIMIN E UJËRAVE TË
NDOTURA PËR SHOQËRINË
UJËSJIJELLËS-KANALIZIME BERAT-
KUÇOVË SHA**

Në mbështetje të neneve 13, 14, 21 dhe 22, të ligjit nr. 8102, datë 28.3.1996 “Për kuadrin rregullator të sektorit të furnizimit me ujë dhe largimit e përpunimit të ujërave të ndotura”, i ndryshuar (ligji nr. 8102), vendimit të Komisionit Kombëtar Rregullator nr. 39, datë 9.12.2015 “Për miratimin e politikës tarifore për shërbimin e furnizimit me ujë dhe largimit e përpunimit të ujërave të ndotura” (vendimi nr. 39), vendimit të Komisionit Kombëtar Rregullator nr. 40, datë 9.12.2015 “Për miratimin e dokumentacionit mbështetës për miratimin e tarifave për shërbimin e furnizimit me ujë, largimin e përpunimit të ujërave të ndotura” (vendimi nr. 40), vendimit të Komisionit Kombëtar Rregullator nr. 41, datë 9.12.2015 “Për miratimin e procesit të miratimit të tarifave për shërbimin e furnizimit me ujë, largimin e përpunimit të ujërave të ndotura” (vendimi nr. 41), vendimit të Komisionit Kombëtar Rregullator nr. 42, datë 9.12.2015 “Për miratimin e metodologjisë për vendosjen e tarifave për shërbimin e furnizimit me ujë dhe largim e përpunimit të ujërave të ndotura” (vendimi nr. 42),

Komisioni Kombëtar Rregullator,

në mbledhjen e datë 10.10.2019, pasi shqyrtoi dokumentacionin e paraqitur nga Drejtoria



Tekniko-Ekonomike mbi kërkesën e Ujësjetës-Kanalizime Berat–Kuçovë sh.a., për miratimin e tarifave të shërbimit të furnizimit me ujë dhe kanalizime,

VËREN SE:

Shoqëria “Ujësjetës-Kanalizime Berat–Kuçovë” (UK Berat–Kuçovë), me shkresën nr. 816 prot., datë 29.6.2018 “Kërkesë për nivel të ri tarife për shërbimin e furnizimit me ujë të pijshëm dhe kanalizime” ka paraqitur kërkesën pranë Entit Rregullator të Sektorit të Furnizimit me Ujë dhe Largimit e Përpunimit të Ujërave të Ndotura (ERRU), për ndryshimin e tarifave në zonën e shërbimit për të tria kategoritë e konsumatorëve, të shoqëruar me dokumentacionin sipas përcaktimeve të parashikuara në ligjin nr. 8102 dhe në vendimin nr. 40.

1. Komisioni Kombëtar Rregullator (KKRR), pasi e gjeti paraqitjen e kërkesës për vendosjen e

tarifave të shërbimit të furnizimit me ujë dhe largimin e ujërave të ndotura dhe tarifë fikse të shoqërisë UK Berat–Kuçovë, në përputhje me përcaktimet dhe procedurën e parashikuar në vendimin nr. 40, me vendimin nr. 56, datë 20.7.2019, vendosi fillimin e procedurës për shqyrtimin e aplikimit për propozimin e bërë nga UK Berat–Kuçovë, për nivelin e ri tarifor për shërbimet UK për të gjithë zonën e riorganizuar të shërbimit në zbatim të VKM-së nr. 63, datë 27.1.2016 “Për riorganizimin e operatorëve që ofrojnë shërbimin e furnizimit me ujë, grumbullimin, largimin dhe trajtimin e ujërave të ndotura”.

2. Ujësjetës-Kanalizime Berat–Kuçovë ka paraqitur dokumentacionin e aplikimit për miratimin e tarifave pranë ERRU-së, me shkresën nr. 816 prot., datë 29.6.2018 “Kërkesë për nivel të ri tarife për shërbimin e furnizimit me ujë të pijshëm dhe kanalizime”, për të tria kategoritë e konsumatorëve, sipas tabelës së mëposhtme:

Tabela me tarifat aktuale dhe të propozuara nga shoqëria sipas kategorisë së konsumatorëve

Njësitë administrative	Kategoria e konsumatorëve	Tarifat aktuale	Tarifat e propozuara	Diferenca
Berat, Kuçovë	a) Për shërbimin e furnizimit me ujë	(lekë/m ³)	(lekë/m ³)	(lekë/m ³)
	1. Klientë familjarë	48	51	+3
	2. Klientë publikë	130	150	+20
	3. Klientë privatë	130	150	+20
	b) Për shërbimin e largimit të ujërave të ndotura	(lekë/m ³)	(lekë/m ³)	(lekë/m ³)
	1. Klientë familjarë	13	14	+1
Otlak, Velabisht, Sinjë, Kozarë, Lumas, Roshnik	2. Klientë publikë	22	24	+2
	3. Klientë privatë	22	24	+2
	a) Për shërbimin e furnizimit me ujë	(lekë/m ³)	(lekë/m ³)	(lekë/m ³)
	1. Klientë familjarë	50	51	+1
	1.1 Klientë familjarë (Roshnik)	40	40	=
	2. Klientë publikë	150	150	=
	3. Klientë privatë	150	150	=
	b) Për shërbimin e largimit të ujërave të ndotura	(lekë/m ³)	(lekë/m ³)	(lekë/m ³)
	1. Klientë familjarë	14	14	=
	2. Klientë publikë	24	24	=
	3. Klientë privatë	24	24	=
c) Tarifë fikse për zonën e shërbimit të riorganizuar		(lekë/muaj/klient)	(lekë/muaj/klient)	(lekë/muaj/klient)
1. Klientë familjarë		100	150	+50
2. Klientë publikë		200	200	=
3. Klientë privatë		200	200	=



3. Në aplikimin aktual, duke marrë si referencë vitin e mbyllur 2018 për të cilin shoqëria ka aplikuar tarifat e miratuara nga ERRU-ja për gjithë zonën e shërbimit, referuar tarifave të reja të propozuara shoqëria ka përcaktuar edhe objektivat që do të realizohen në vitin e ardhshëm. Treguesit kryesorë të performancës për vitin 2018 dhe objektivat për vitin 2019 jepen në tabelën e mëposhtme.

Treguesit kryesorë të performancës sipas shoqërisë për vitet 2018–2019

Treguesit e performancës	Njësia	Treguesit e performancës	
		Viti 2018	Objektivat Viti 2019
Uji pa të ardhura	%	77	76
Mbulimi i kostove O&M	%	98.7	142
Mbulimi i kostove totale	%	86.7	106
Niveli i matjes	%	72.5	77
Vazhdimësia e FU	orë/ditë	14	16
Efikasiteti i stafit	staf/1000/lidhje	4.8	4.8
Mbulimi me ujë	%	71	71
Mbulimi me KUN	%	50	50
Norma e arkëtimit korrente	%	85	87

4. Në dokumentacionin e paraqitur, shoqëria jep argumentet në të cilën mbështet nevojën për të ardhura shtesë, nëpërmjet tarifave të propozuara shoqëria synon:

- Për të plotësuar kushtet për kualifikimin dhe përfundimin në programin e ardhshëm të investimeve të financuar nga KfW-ja, ku sipas raportimeve nga shoqëria janë:

- norma e përgjithshme e arkëtimit në nivelin 92%-94%;

- uji pa të ardhura në nivelin 75% pas investimit MIP II;

- mesatarja e orëve të furnizimit me ujë 8 orë/ditë dhe për zonat e investuara 24 orë/ditë;

- numri total i punonjësve të shoqërisë për vitin 2019 të jetë 252;

- mbulimi i kostove OM dhe kostot e borxhit me arkëtimet në masën 100%;

- Rritjen e nivelit të mbulueshmërisë me shërbimet UK, nëpërmjet investimeve infrastrukturore dhe zgjerimin e rrjetit për zonën rurale. Në zonën e fshatit Tapi do të ketë shtesë të numrit të abonentëve me 10 kontrata të reja dhe do të pajisen me matës 60 abonentë. Gjithashtu, do të zëvendësohet rrjeti në fshatrat: Velabishte, Starove, Veterik, Remanic, Bilce. Shoqëria sqaron se këto investime do t'i realizojë me kapacitetet e veta, kostot e të cilave janë parashikuar në zërat "Shpenzime materiale" dhe "Kostot e punës".

- Përmirësimin e cilësisë së shërbimit në zonën rurale në drejtim të rritjes së kohëzgjatjes së furnizimit me ujë, i cili aktualisht ofrohet mesatarisht 4 orë në ditë.

- Mbulimin e shpenzimeve të riparimeve për eliminimin e defekteve apo lidhjeve të paligjshme, instalimin e matësve, rregullimin dhe menaxhimin e rrjetit të furnizimit.

- Shlyerjen e borxhit afatgjatë të akumuluar ndaj institucioneve të kredisë, të cilin shoqëria e ka shlyer pjesërisht duke mos respektuar grafikun e shlyerjes së tyre për shkak të mungesës së likuiditetit, sepse ajo ende ka shumë detyrime ndaj Ministrisë së Financave.

Në mbyllje të vitit 2018, me detyrime të pashlyera në kohë ndaj Ministrisë së Financave (si garanti i kredisë) rezulton si më poshtë:

1.1 Detyrim për principalin e kredisë 1 073 000 euro;

1.2 Detyrim për interesat 422 839 euro;

1.3 Penalitetet 51 695 euro.

Për fshatin Qereshnik, vlera e investimit nga Bashkia është 36 991 000 lekë, që do të transferohet si aset për shoqërinë brenda vitit 2019. Pritet të realizohet furnizimi me 24/orë ujë e rreth 800 banorëve, nga të cilët do të lidhen 200 kontrata të reja.

Për fshatin Kostren 1, vlera e investimit nga Bashkia është 5 000 000 lekë, që do të transferohet



si aset për shoqërinë brenda vitit 2019. Pritet të realizohet furnizimi me 24/orë ujë e rreth 400 banorëve, nga të cilët do të lidhen 50 kontrata të reja.

Për fshatin Mbreshtan, vlera e investimit nga Bashkia është 37 000 000 lekë, që do të transferohet si aset për shoqërinë brenda vitit 2020. Pritet të realizohet furnizimi me 24/orë ujë, nga të cilët do të lidhen rreth 130–180 kontrata të reja.

5. ERRU-ja, gjatë procesit të analizës teknike-ekonomike sipas metodologjisë së llogaritjes së tarifave, të përcaktuar në vendimin nr. 42, ka kërkuar nga UK Berat–Kuçovë informacion shtesë, si dhe verifikim të saktësisë së të dhënave, të cilat janë vënë në dispozicion.

6. ERRU-ja, në vlerësimin e tarifave të propozuara dhe treguesve të performancës, si dhe në analizën ekonomike-financiare, ka marrë në konsideratë përmbushjen nga ana e UK Berat–Kuçovë, të:

a) kërkesave të ligjit nr. 8102, si dhe të akteve nënligjore dhe kuadrit rregullator në fuqi, në mënyrë të veçantë mbrojtjen e konsumatorëve nga çmimet monopol;

b) kërkesave të ligjit nr. 9121, datë 28.7.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës”, të ndryshuar (ligji nr. 9121), për moslejimin e abuzimit me pozitën dominuese në treg të ndërmarrjes nëpërmjet vendosjes, në mënyrë të drejtpërdrejtë ose të tërthortë, të çmimeve të padrejta të shitjes apo e kushteve të tjera të tregtimit;

c) kërkesave të ligjit nr. 9902, datë 17.4.2008 “Për mbrojtjen e konsumatorëve”, të ndryshuar (ligji nr. 9902);

d) orientimin drejt mbulimit të kostove O&M, pasi aktualisht shoqëria bën pjesë në grupin e shoqërive që tentojnë mbulimin e këtyre kostove;

e) tarifat e propozuara nga operatori të jenë në përputhje të plotë me parimin ligjor rregullator mbi përballueshmërinë, sipas të cilit tarifat duhet të jenë të përballueshme;

f) tarifat e propozuara nuk sjellin për pasojë efekte negative në mjedis nga veprimtaria e operatorit në zonën e shërbimit që ato do të aplikohen;

g) propozimin për ndryshimin e tarifave nga shoqëria, ERRU-ja e gjen të justifikuar, por jo në nivelin e propozuar nga shoqëria, referuar kjo analizës teknike-ekonomike, si dhe realizimit të

objektivave të performancës të përcaktuar në aplikimin paraardhës.

7. ERRU-ja, në bazë të analizës, verifikimeve dhe komunikimit me stafin drejtues të shoqërisë i konsideron të arritshëm objektivat mbi treguesit e performancës dhe për këtë rekomandon:

a) shoqëria duhet të hartojë planbiznesin 5-vjeçar sipas riorganizimit në kuadër të VKM-së nr. 63, pasi biznesplanin i paraqitur nuk është në nivelin e kërkuar, duke marrë parasysh edhe faktin që kjo shoqëri përfiton konsulencë të jashtme për këto qëllime;

b) shoqëria duhet të hartojë një plan masash të detajuar për vjeljen e debive të prapambetura dhe në përputhje me kërkesat e reformës së ujit;

c) shoqëria duhet të zgjidhë situatën me UK Poliçan në drejtim të shitjes së ujit me shumicë pasi kontrata ende nuk është nënshkruar dhe UK Poliçan furnizohet me ujë, por nuk faturohet;

d) për të hartuar bilancin e ujit sa më real, në të gjithë nënçerërat e tij, duhet të angazhojë stafin për vlerësimin sa më të saktë e çdo komponenti të bilancit të jetë i monitoruar gjatë gjithë vitit, të mbajë evidenca mbi sasitë e ujit që nuk maten, mbi sasitë e autorizuara të pafaturuara etj.;

e) të shpëpusë nga sistemi i furnizimit të gjitha linjat e vjetra, duke përfshirë dhe godinat me kolonë të brendshme, të cilat furnizohen me dy linja;

f) të eliminojë humbjet e ujit për shkak të lidhjeve të paligjshme në linjën e transmetimit dhe të shpërndarjes;

g) të evidentojë në terren numrin e klientëve;

h) të riparojë në kohë defektet e shumta në rrjet, si dhe të vlerësojë sasinë e ujit që humbet para dhe gjatë riparimit;

i) të hartojë planin e masave për reduktimin e humbjeve të ujit.

Komisioni Kombëtar Rregullator, pasi vlerësoi tarifat e propozuara nga operatori mbi bazën e Metodologjisë, të miratuar me vendim nr. 42, datë 9.12.2015 “Për miratimin e metodologjisë për vendosjen e tarifave për shërbimin e furnizimit me ujë dhe largim e përpunimin e ujërave të ndotura”, si dhe akteve të tjera rregullatore që lidhen me të, arrin në konkluzionin se tarifat e propozuara sipas analizës së kryer janë të bazuara dhe në zbatim të kriterëve ligjorë referuese lidhur me kostot e pranueshme dhe të justifikuara, si dhe përballueshmërinë, nuk janë të padrejta dhe të



vendosura në kushtet e abuzimit me pozitën dominuese në treg të operatorit ekonomik në kuptim të ligjit nr. 9121, “Për mbrojtjen e konkurrencës”, të ndryshuar, dhe ligjin nr. 9902 “Për mbrojtjen e konsumatorëve”, për gjithë sa më sipër, në zbatim të neneve 13, 14 dhe 22, të ligjit nr. 8102, datë 28.3.1996 “Për kuadrin rregullator të

sektorit të furnizimit me ujë dhe largimit e përpunimit të ujërave të ndotura”, i ndryshuar,

VENDOSI:

1. Miratimin e tarifave për shoqërinë Ujësjellës-Kanalizime Berat–Kuçovë, si më poshtë:

Kategoria	Tarifat sipas vendimit në zonën e shërbimit
Tarifë volumetrike për furnizimin me ujë	Lekë/m³
Konsumatorë familjarë	50
Konsumatorë familjarë NJA Roshnik	40
Konsumatorë publikë	130
Konsumatorë privatë	130
Tarifë volumetrike për KUN-in	Lekë/m³
Konsumatorë familjarë	14
Konsumatorë publikë	24
Konsumatorë privatë	24
Tarifë fikse	Lekë/muaj/lidhje
Konsumatorë familjarë	100
Konsumatorë publikë	200
Konsumatorë privatë	200

2. Objektivat e treguesve kryesorë të performancës të vitit 2020 për shoqërinë UK Berat–Kuçovë, të jenë:

Treguesit e performancës	Njësia e matjes	Niveli i objektivit për vitin 2020 të përcaktuar nga ERRU-ja
Mbulimi i kostove totale	%	96.8
Uji pa të ardhura	%	74
Niveli i matjes	%	82
Vazhdimësia e furnizimit me ujë	orë/ditë	16
Eficienca e stafit	staf/1000 lidhje	4.81
Mbulimi me ujë	%	71
Mbulimi me KUN	%	50
Norma e arkëtimit korente	%	87

3. Pagesa rregullatore vjetore për shoqërinë Ujësjellës-Kanalizime Berat–Kuçovë sh.a. do të jetë 0.6% e të ardhurave vjetore të parashikuara nga aktiviteti.

4. Lidhjen e kontratës me UK Berat–Kuçovë, brenda 30 ditëve nga data e njoftimit sipas pikës 4, të nenit 22, të ligjit nr. 8102.

5. Vendimi nr. 13, datë 30.3.2017 “Mbi tarifat e ujit për konsum publik për shoqërinë UK Berat–Kuçovë sh.a.”, shfuqizohet.

6. Vendimi nr. 57, datë 29.12.2017 “Për një shtesë dhe ndryshim në vendimin e KKRR-së nr. 13, datë 30.3.2017 ‘Mbi tarifat e ujit për konsum publik për shoqërinë UK Berat–Kuçovë’”, shfuqizohet.

7. Ky vendim hyn në fuqi në datën 1.11.2019 dhe është i vlefshëm deri në miratimin e tarifave të reja.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETAR
Ndriçim Shani



VENDIM

Nr. 51, datë 28.10.2019

**PËR MIRATIMIN E TARIFAVE TË
SHËRBIMIT TË FURNIZIMIT ME UJË
DHE LARGIMIN E UJËRAVE TË
NDOTURA PËR SHOQËRINË
UJËSJELLËS-KANALIZIME VLOREË SHA.**

Në mbështetje të neneve 13, 14, 21 dhe 22, të ligjit nr. 8102, datë 28.3.1996 “Për kuadrin rregullator të sektorit të furnizimit me ujë dhe largimit e përpunimit të ujërave të ndotura”, i ndryshuar (ligji nr. 8102), vendimit të Komisionit Kombëtar Rregullator nr. 39, datë 9.12.2015 “Për miratimin e politikës tarifore për shërbimin e furnizimit me ujë dhe largimit e përpunimit të ujërave të ndotura” (vendimi nr. 39), vendimit të Komisionit Kombëtar Rregullator nr. 40, datë 9.12.2015 “Për miratimin e dokumentacionit mbështetës për miratimin e tarifave për shërbimin e furnizimit me ujë, largimin e përpunimin e ujërave të ndotura” (vendimi nr. 40), vendimit të Komisionit Kombëtar Rregullator nr. 41, datë 9.12.2015 “Për miratimin e procesit të miratimit të tarifave për shërbimin e furnizimit me ujë, largimin e përpunimin e ujërave të ndotura” (vendimi nr. 41), vendimit të Komisionit Kombëtar Rregullator nr. 42, datë 9.12.2015 “Për miratimin e metodologjisë për vendosjen e tarifave për shërbimin e furnizimit me ujë dhe largim e përpunimin e ujërave të ndotura” (vendimi nr. 42),

Komisioni Kombëtar Rregullator,

në mbledhjen e datës 28.10.2019, pasi shqyrtoi dokumentacionin e paraqitur nga Drejtoria Tekniko-Ekonomike mbi kërkesën e Ujësjiellës-Kanalizime Vlorë sh.a., për miratimin e tarifave të shërbimit të furnizimit me ujë dhe kanalizime,

VËREN SE:

Shoqëria “Ujësjiellës-Kanalizime Vlorë” (UK Vlorë), me shkresë nr. 666 prot., datë 28.6.2018, me lëndë “Kërkesë për nivel të ri tarife për shërbimin e furnizimit me ujë dhe largimin (kanalizime) e ujërave të ndotura” ka paraqitur kërkesën pranë Entit Rregullator të Sektorit të Furnizimit me Ujë dhe Largimit e Përpunimit të Ujërave të Ndotura (ERRU) për ndryshimin e tarifave në zonën e shërbimit për të tria kategoritë e konsumatorëve të shoqëruar me dokumentacionin sipas përcaktimeve të parashikuara në ligjin nr. 8102 dhe në vendimin nr. 40.

1. Komisioni Kombëtar Rregullator (KKRR), pasi e gjeti paraqitjen e kërkesës për vendosjen e tarifave të shërbimit të furnizimit me ujë dhe largimin e ujërave të ndotura dhe tarifë fikse të shoqërisë UK Vlorë në përputhje me përcaktimet dhe procedurën e parashikuar në vendimin nr. 40, me vendimin nr. 73, datë 1.10.2018 vendosi fillimin e procedurës për shqyrtimin e aplikimit për propozimin e bërë nga UK Vlorë për nivelin e ri tarifor për shërbimet UK për të gjithë zonën e riorganizuar të shërbimit në zbatim të VKM-së nr. 63, datë 27.1.2016 “Për riorganizimin e operatorëve që ofrojnë shërbimin e furnizimit me ujë, grumbullimin, largimin dhe trajtimin e ujërave të ndotura”.

2. Ujësjiellës-Kanalizime Vlorë, në dokumentacionin e paraqitur pranë ERRU-së, me shkresë nr. 666 prot., datë 28.6.2018 “Kërkesë për nivel të ri tarife për shërbimin e furnizimit me ujë dhe largimin (kanalizime) e ujërave të ndotura” propozon ndryshim të nivelit tarifor për të tria kategoritë e konsumatorëve sipas tabelës së mëposhtme:



Tabela 2. Tabela me tarifat aktuale dhe të propozuara nga shoqëria sipas kategorisë së konsumatorëve

Kategoritë e klientëve	Tarifat aktuale				Tarifat e propozuara		Ndryshimi i tarifave të propozuara me ato aktuale			
	Njësitë administrative				Njësitë administrative		Njësitë administrative			
	Vlorë	Orikum	Novoselë	Qendër, Shushicë	Vlorë Orikum Novoselë	Komuna Qendër, Shushicë	Vlorë	Orikum	Novoselë	Qendër, Shushicë
A. Tarifë volumetrike FU	Lekë/m ³	Lekë/m ³	Lekë/m ³	Lekë/m ³	Lekë/m ³	Lekë/m ³	Lekë/m ³	Lekë/m ³	Lekë/m ³	Lekë/m ³
Klientë familjarë	30	25	33	30	50	50	20	25	17	20
Klientë publikë	60	70	50	60	146	90	86	76	96	30
Klientë privatë	80	75	70	80	100	95	20	25	30	15
B. Tarifë volumetrike KUN	Lekë/m ³	Lekë/m ³	Lekë/m ³	Lekë/m ³	Lekë/m ³	Lekë/m ³	Lekë/m ³	Lekë/m ³	Lekë/m ³	Lekë/m ³
Klientë familjarë	11	0	0	0	15	0	4	0	0	0
Klientë publikë	13	0	0	0	45	0	32	0	0	0
Klientë privatë	13	0	0	0	45	0	32	0	0	0
C. Tarifë fikse mujore	Lekë/muaj	Lekë/muaj	Lekë/muaj	Lekë/muaj	Lekë/muaj	Lekë/muaj	Lekë/muaj	Lekë/muaj	Lekë/muaj	Lekë/muaj
Klientë familjarë	80	100	0	80	150	100	70	50	150	20
Klientë publikë	80	100	0	80	150	100	70	50	150	20
Klientë privatë	80	100	0	80	150	100	70	50	150	20

3. Në aplikimin aktual, duke marrë si referencë vitin e mbyllur 2018, për të cilin shoqëria ka aplikuar tarifat e miratuara nga ERRU-ja për gjithë zonën e shërbimit, referuar tarifave të reja të propozuara shoqëria ka përcaktuar edhe objektivat që do të realizohen në vitin e ardhshëm. Treguesit kryesorë të performancës për vitin 2018 dhe objektivat për vitin 2019 jepen në tabelën e mëposhtme.

Treguesit kryesorë të performancës sipas shoqërisë për vitet 2018–2019

Treguesit e performancës	Njësia e matjes	Treguesit e performancës sipas Shoqërisë		
		viti 2017	viti 2018	viti 2019
Mbulimi i kostove O&M	%	63	63	107
Uji pa të ardhura	%	79.3	77.1	75.9
Mbulimi me ujë	%	78.7	81	81
Mbulimi me KUN-në	%	55	62	64.5
Niveli i matjes	%	40	49	57
Norma e arkëtimit korente	%	51	60	72
Vazhdimësia e furnizimit me Ujë	orë/ditë	11.1	12.1	12.63
Efienca e stafit	staf/1000 lidhje UK	4.2	4	3.9



4. Shoqëria në relacionin e saj e justifikon nevojën e ndryshimit të tarifave duke dhënë argumentet e mëposhtme:

- pas riorganizimit të shoqërisë aplikon për ndryshimin e nivelit tarifor në zbatim të VKM-së nr. 63, datë 27.1.2016 “Për riorganizimin e operatorëve që ofrojnë shërbimin e furnizimit me ujë të pijshëm, grumbullimin, largimin dhe trajtimin e ujërave të ndotura”;

- aplikon për nivel të ri tarifor pas një periudhe të gjatë 6-vjeçare;

- kostot e energjisë zënë rreth 35% të kostove të shoqërisë. Ndryshimi i çmimit të energjisë elektrike në vitin 2014 e në vijim, me një rritje mesatarisht 5 lekë/kwh ka dhënë ndikim të ndjeshëm në kostot e energjisë elektrike;

- kostot e operimit dhe të mirëmbajtjes mbulohen në nivelin 63% dhe synimi i shoqërisë nëpërmjet këtij niveli tarifor të propozuar është mbulimi mbi 100% i tyre.

Edhe pse me tendencë të ulët, përmirësimi i treguesit “Uji pa të ardhura” vazhdon të jetë në nivele të larta. “Niveli i matjes” është shumë i ulët, vetëm 49% e klientëve janë të pajisur me matës. Dobët paraqitet edhe treguesi “Norma e arkëtimit korente”, i cili për vitin 2018 është 60%, shërbimi i kanalizimeve ofrohet vetëm për zonën urbane në nivelin 62% kundrejt popullsisë në zonën e juridiksionit.

- Tarifatat e reja të propozuara synojnë edhe mbulimin e shpenzimeve të riparimeve për eliminimin e defekteve apo lidhjeve të paligjshme, instalimin e matësve, rregullimin dhe menaxhimin e rrjetit të furnizimit.

Ujësjiellës-Kanalizime Vlorë synon që me tarifatat e reja të propozuara të mbulojë kostot e operimit dhe mirëmbajtjes mbi 100%, si edhe rritjen e normës së arkëtimit nga 60% që është aktualisht në 72% për vitin 2019 për të pasur një situatë financiare më të favorshme me qëllim dhe thithjen e investimeve. Niveli i matjes është parashikuar të rritet 8 %, ndërsa treguesi “Uji pa të ardhura” do të shënojë një përmirësim me vetëm 1,2%.

5. ERRU-ja, gjatë procesit të analizës teknike ekonomike sipas metodologjisë së llogaritjes së tarifave të përcaktuar në vendimin nr. 42, ka kërkuar nga UK Vlorë informacion shtesë, si dhe verifikim të saktësisë së të dhënave, të cilat janë vënë në dispozicion.

6. ERRU-ja, në vlerësimin e tarifave të propozuara dhe treguesve të performancës, si dhe në analizën ekonomike financiare, ka marrë në konsideratë përmbushjen nga ana e UK Vlorë, të:

- a) kërkesave të ligjit nr. 8102, si dhe të akteve nënligjore dhe kuadrit rregullator në fuqi, në mënyrë të veçantë mbrojtjen e konsumatorëve nga çmimet monopol;

- b) kërkesave të ligjit nr. 9121, datë 28.7.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës”, të ndryshuar (ligji nr. 9121), për moslejimin e abuzimit me pozitën dominuese në treg të ndërmarrjes nëpërmjet vendosjes, në mënyrë të drejtpërdrejtë ose të tërthortë, të çmimeve të padrejta të shitjes apo e kushteve të tjera të tregtimit;

- c) kërkesave të ligjit nr. 9902, datë 17.4.2008 “Për mbrojtjen e konsumatorëve”, të ndryshuar (ligji nr. 9902);

- d) orientimin drejt mbulimit të kostove O&M pasi aktualisht shoqëria bën pjesë në grupin e shoqërive që tentojnë mbulimin e këtyre kostove;

- e) tarifatat e propozuara nga operatori të jenë në përputhje të plotë me parimin ligjor rregullator mbi përbalueshmërinë, sipas të cilit tarifatat duhet të jenë të përbalueshme;

- f) tarifatat e propozuara nuk sjellin për pasojë efekte negative në mjedis nga veprimtaria e operatorit në zonën e shërbimit që ato do të aplikohen;

- g) propozimin për ndryshimin e tarifave nga shoqëria, ERRU-ja e gjen të justifikuar, por jo në nivelin e propozuar nga shoqëria, referuar kjo analizës teknike-ekonomike, si dhe realizimit të objektivave të performancës të përcaktuar në aplikimin paraardhës.

7. ERRU-ja, në bazë të analizës, verifikimeve dhe komunikimit me stafin drejtues të shoqërisë i konsideron të arritshëm objektivat mbi treguesit e performancës dhe për këtë rekomandon:

- a) saktësia e informacionit është pikënisje për një analizë dhe gjykim të drejtë nga ERRU-ja, si aplikim i parë pas riorganizimit stafi i ERRU-së ka punuar shumë duke mbajtur kontakte të vazhdueshme me shoqërinë për plotësimin e të dhënave teknike dhe ekonomike. Në aplikimin e ardhshëm ERRU-ja nuk do të pranojë aplikim me probleme në lidhje me saktësinë, që e zgjasim mjaft kohën e analizës së aplikimit nga ERRU-ja;

- b) shoqëria duhet të hartojë një plan masash të detajuar për vjeljen e debive të prapambetura dhe



në përputhje me kërkesat e reformës së ujit. Të ndjekë hapat ligjorë me qëllim krijimin e provizionit për ata klientë që janë pa shpresë kthimi;

c) të plotësojë me matës të mëdhenj të gjitha pikat e prodhimit të ujit në të cilat prodhimi ende vlerësohet, gjithashtu, të vendosë matës dhe në pikat kryesore të rrjetit;

d) të organizojë task-forcën e re për të vazhduar aksionin për gjetjen dhe eliminimin e të gjitha lidhjeve të paligjshme në rrjetin e transmetimit dhe të shpërndarjes;

e) të gjejë mundësitë për të nxjerrë jashtë pune rrjetin e vjetër të furnizimit i cili shkakton humbje fizike në nivele të larta;

f) të mbajë nën kontroll të gjithë sistemin e furnizimit për të reaguar në kohën e duhur ndaj defekteve, për të minimizuar sa më shumë humbjet nga rrjedhjet;

g) për të hartuar bilancin e ujit sa më real, në të gjithë nën zërat e tij, duhet të angazhojë stafin për vlerësimin sa më të saktë të çdo komponenti të bilancit të ujit;

h) të evidentojë në terren numrin e klientëve, asetet për të dyja shërbimet, sidomos ato të zonave të reja administrative në të cilat dhe informacioni nuk është i qartë.

Komisioni Kombëtar Rregullator, pasi vlerësoi tarifën e propozuar nga operatori mbi bazën e Metodologjisë, të miratuar me vendim nr. 42, datë 9.12.2015 “Për miratimin e metodologjisë për vendosjen e tarifave për shërbimin e furnizimit me ujë dhe largim e përpunimit të ujërave të ndotura”, si dhe akteve të tjera rregullatore që lidhen me të, arrin në konkluzionin se tarifën e propozuar sipas analizës së kryer janë të bazuara dhe në zbatim të kriterëve ligjorë referues lidhur me kostot e pranueshme dhe të justifikuar, si dhe përballueshmërinë, nuk janë të padrejta dhe të vendosura në kushtet e abuzimit me pozitën dominuese në treg të operatorit ekonomik në kuptim të ligjit nr. 9121, “Për mbrojtjen e konkurrencës”, të ndryshuar, dhe ligjin nr. 9902 “Për mbrojtjen e konsumatorëve”, për gjithë sa më sipër, në zbatim të neneve 13, 14 dhe 22, të ligjit nr. 8102, datë 28.3.1996 “Për kuadrin rregullator të sektorit të furnizimit me ujë dhe largimit e përpunimit të ujërave të ndotura”, i ndryshuar,

VENDOSI:

1. Miratimin e tarifave për shoqërinë Ujësjellës-Kanalizime Vlorë, si më poshtë:

Kategoria	Tarifat sipas vendimit në zonën e shërbimit
Tarifë volumetrike për furnizimin me ujë	Lekë/m ³
Konsumatorë familjarë	45
Konsumatorë publik	100
Konsumatorë privat	100
Tarifë volumetrike për KUN	Lekë/m ³
Konsumatorë familjarë	15
Konsumatorë publikë	25
Konsumatorë privatë	25
Tarifë fikse	Lekë/muaj/lidhje
Konsumatorë familjarë	100
Konsumatorë publikë	150
Konsumatorë privatë	150



2. Objektivat e treguesve kryesorë të performancës të vitit 2020 për shoqërinë UK Vlorë, të jenë:

Treguesit e performancës	Njësia e matjes	Niveli i objektivit për vitin 2020 të përcaktuar nga ERRU-ja
Mbulimi i kostove O&M	%	100
Uji pa të ardhura	%	73
Niveli i matjes	%	65
Vazhdimësia e furnizimit me ujë	orë/ditë	12.63
Eficienca e stafit	staf/1000 lidhje	3.9
Mbulimi me ujë	%	81
Mbulimi me KUN	%	64.5
Norma e arkëtimit korente	%	72

3. Pagesa rregullatore vjetore për shoqërinë Ujësjetllës-Kanalizime Vlorë sh.a. do të jetë 0.6% e të ardhurave vjetore të parashikuara nga aktiviteti.

4. Lidhjen e kontratës me UK Vlorë brenda 30 ditëve nga data e njofimit sipas pikës 4, të nenit 22, të ligjit nr. 8102.

5. Vendimi nr. 11, datë 15.3.2011 “Për miratimin e tarifave të ujit për konsum publik për shoqërinë UK Vlorë sh.a.”, shfuqizohet.

6. Vendimi nr. 46, datë 26.12.2011 “Për miratimin e tarifave të ujit për konsum publik për shoqërinë U Orikum sh.a.”, shfuqizohet.

7. Vendimi nr. 52, datë 10.12.2010 “Për miratimin e tarifave të ujit për konsum publik për shoqërinë U Novoselë sh.a.”, shfuqizohet.

8. Ky vendim hyn në fuqi më datë 1.12.2019 dhe është i vlefshëm deri në miratimin e tarifave të reja.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETAR
Ndriçim Shani

VENDIM
Nr. 52, datë 28.10.2019

PËR MIRATIMIN E TARIFAVE TË SHËRBIMIT TË FURNIZIMIT ME UJË DHE LARGIMIN E UJËRAVE TË NDOTURA PËR SHOQËRINË UJËSJELLËS-KANALIZIME KRUJË SHA

Në mbështetje të neneve 13, 14, 21 dhe 22, të ligjit nr. 8102, datë 28.3.1996 “Për kuadrin rregullator të sektorit të furnizimit me ujë dhe

largimit e përpunimit të ujërave të ndotura”, i ndryshuar (ligji nr. 8102), vendimit të Komisionit Kombëtar Rregullator nr. 39, datë 9.12.2015 “Për miratimin e politikës tarifore për shërbimin e furnizimit me ujë dhe largimit e përpunimit të ujërave të ndotura” (vendimi nr. 39), vendimit të Komisionit Kombëtar Rregullator nr. 40, datë 9.12.2015 “Për miratimin e dokumentacionit mbështetës për miratimin e tarifave për shërbimin e furnizimit me ujë, largimin e përpunimit të ujërave të ndotura” (vendimi nr. 40), vendimit të Komisionit Kombëtar Rregullator nr. 41, datë 9.12.2015 “Për miratimin e procesit të miratimit të tarifave për shërbimin e furnizimit me ujë, largimin e përpunimit të ujërave të ndotura” (vendimi nr. 41), vendimit të Komisionit Kombëtar Rregullator nr. 42, datë 9.12.2015 “Për miratimin e metodologjisë për vendosjen e tarifave për shërbimin e furnizimit me ujë dhe largim e përpunimit të ujërave të ndotura” (vendimi nr. 42),

Komisioni Kombëtar Rregullator,

në mbledhjen e datës 28.10.2019, pasi shqyrtoi dokumentacionin e paraqitur nga Drejtoria Tekniko-Ekonomike mbi kërkesën e Ujësjetllës-Kanalizime Krujë sh.a. për miratimin e tarifave të shërbimit të furnizimit me ujë dhe kanalizime,

VËREN SE:

1. Shoqëria “Ujësjetllës-Kanalizime Krujë” (UK Krujë), me shkresë nr. 1252 prot., datë 28.6.2018 “Kërkesë për nivel të ri tarife për shërbimin e furnizimit me ujë të pijshëm dhe kanalizime” ka



paraqitur kërkesën pranë Entit Rregullator të Sektorit të Furnizimit me Ujë dhe Largimit e Përpunimit të Ujërave të Ndotura (ERRU) për rritjen e tarifave në zonën e shërbimit për të tria kategoritë e konsumatorëve të shoqëruar me dokumentacionin sipas përcaktimeve të parashikuara në ligjin nr. 8102 dhe në vendimin nr. 40.

2. Komisioni Kombëtar Rregullator (KKRR), pasi e gjeti paraqitjen e kërkesës për vendosjen e tarifave të shërbimit të furnizimit me ujë dhe largimin e ujërave të ndotura dhe tarifës fikse të shoqërisë UK Krujë në përputhje me përcaktimet dhe procedurën e parashikuar në vendimin nr. 40, me vendimin nr. 72, datë 1.10.2019, vendosi

fillimin e procedurës për shqyrtimin e aplikimit për propozimin e bërë nga UK Krujë për nivelin e ri tarifor për shërbimet UK për të gjithë zonën e riorganizuar të shërbimit në zbatim të VKM-së nr. 63, datë 27.1.2016 “Për riorganizimin e operatorëve që ofrojnë shërbimin e furnizimit me ujë, grumbullimin, largimin dhe trajtimin e ujërave të ndotura”.

3. Ujësjiellës-Kanalizime Krujë ka paraqitur dokumentacionin e aplikimit për miratimin e tarifave pranë ERRU-së me shkresë nr. 1252 prot., datë 28.6.2018 “Kërkesë për nivel të ri tarife për shërbimin e furnizimit me ujë të pijshëm dhe kanalizime” për të tria kategoritë e konsumatorëve sipas tabelës së mëposhtme:

Tabela me tarifat aktuale dhe të propozuara nga shoqëria sipas kategorisë së konsumatorëve

Kategoritë e klientëve	Tarifat aktuale		Tarifat e propozuara	Ndryshimi	
	Njësitë administrative		E gjithë zona e shërbyer	Njësitë administrative	
	Krujë, Cudhi	Bubq, Fushë-Krujë, Nikël, Kodër Thumanë		Krujë, Cudhi	Bubq, Fushë-Krujë, Nikël, Kodër Thumanë
A. Tarifë volumetrike për furnizimin me ujë	Lekë/m³	Lekë/m³	Lekë/m³	Lekë/m³	Lekë/m³
1. Klientë familjarë	33	28	35	+2	+7
2. Klientë publik	80	60	100	+20	+40
3. Klientë privat	80	80	120	+40	+40
B. Tarifë volumetrike për KUN-in	Lekë/m³	Lekë/m³	Lekë/m³	Lekë/m³	Lekë/m³
1. Klientë familjarë	8	6	8	-	+2
2. Klientë publikë	12	10	12	-2	-
3. Klientë privatë	12	12	12	-	-
C. Tarifë fikse	Lekë /muaj	Lekë /muaj	Lekë /muaj	Lekë /muaj	Lekë /muaj
1. Klientë familjarë	50	100	100	+50	0
2. Klientë publikë	100	200	200	+100	0
3. Klientë privatë	100	200	200	+100	0

4. Referuar kërkesës dhe dokumentacionit shoqërues, rezulton se treguesit e arritur të performancës për vitin 2018 dhe objektivat e propozuar nga shoqëria UK Krujë për vitin 2019 janë sipas tabelës së mëposhtme:

Tabela me treguesit kryesorë të performancës sipas shoqërisë për vitet 2018–2019

Treguesit e performancës	Njësia e matjes	Treguesit e performancës sipas shoqërisë	
		Viti 2018	Viti 2019
Mbulimi i kostove O&M	%	58.5	76.6
Mbulimi i kostove totale	%	46.1	60.1
Uji pa të ardhura	%	55.9	55.1
Mbulimi me ujë	%	42.5	42.5
Mbulimi me KUN	%	25.7	25.7
Niveli i matjes	%	75.3	88
Norma e arkëtimit korente	%	71.9	75.4
Vazhdimësia e furnizimit me ujë	orë/ditë	8	8
Eficienca e stafit	staf/1000/ lidhje	5.6	5.5



Në Metodologjinë e Vendosjes së Tarifave për shërbimin e furnizimit me ujë dhe largimin e përpunimit të ujërave të ndotura, miratuar me vendimin e KKRR-së nr. 42, datë 9.12.2015, në nenin 16 të saj “Vlerësimi i propozimit për ndryshim tarife – periudha tranzitore”, citohet: “Për propozimin e parë për ndryshimin e tarifës, brenda periudhës tranzitore, për rastet kur shtohet një zonë e re si pjesë e zonës së shërbimit të operatorit, sipas kësaj metodologjie do të bëhet vetëm analiza e kostos. Më tej, ERRU-ja do të përcaktojë një grup treguesish bazë performance për çdo operator, të cilët do të shërbejnë si referencë dhe do të vlerësohen gjatë ndryshimeve të tarifave për periudhat në vazhdim”.

Nevoja e ndryshimit të tarifave sipas UK Krujë, me qëllim gjenerimin e të ardhurave shtesë argumentohet si më poshtë:

a) pas zgjerimit të zonës së shërbimit Shoqëria aplikon për herë të parë sipas Metodologjisë “Për vendosjen e tarifave për shërbimin e furnizimit me ujë dhe largimin e përpunimit të ujërave të ndotura”, miratuar nga Komisioni Kombëtar Rregullator me vendimin nr. 42, datë 9.12.2015, bazuar në analizën e gjendjes teknike dhe ekonomike të saj, konkretisht analizën e kostove dhe të ardhurave për shërbimet e ofruara, analizën dhe përcaktimin e objektivave për treguesit e performancës;

b) shoqëria aplikon për miratimin e nivelit të ri tarifar pas një periudhe 11-vjeçare (aplikimi i fundit në vitin 2007), duke propozuar unifikim dhe rritje të tarifës volumetrike për shërbimin e furnizimit me ujë të pijshëm, kanalizime dhe tarifës fikse për të tria kategoritë e konsumatorëve;

c) përmirësimin e situatës financiare të shoqërisë që do të reflektohet në ndryshimin e nivelit të mbulimit të kostove të operimit dhe mirëmbajtjes në 76.6% nga 58.5% që ishte në vitin 2018;

d) përmirësimin e nivelit të matjes nga instalimi i 2,000 matësve të rinj përgjatë vitit 2019, duke e çuar nivelin e matjes në 88%;

e) pajisjen me matës e të gjithë klientëve jofamiljarë.

5. ERRU-ja, gjatë procesit të analizës teknike ekonomike sipas Metodologjisë së Llogaritjes së Tarifave, të përcaktuar në vendimin nr. 42, ka kërkuar nga UK Krujë informacion shtesë, si dhe verifikim të saktësisë së të dhënave, të cilat janë vënë në dispozicion.

6. ERRU-ja, në vlerësimin e tarifave të propozuara dhe treguesve të performancës, si dhe në analizën ekonomike financiare, ka marrë në konsideratë përmbushjen nga ana e UK Krujë, të:

a) kërkesave të ligjit nr. 8102, si dhe të akteve nënligjore dhe kuadrit rregullator në fuqi, në mënyrë të veçantë mbrojtjen e konsumatorëve nga çmimet monopol;

b) kërkesave të ligjit nr. 9121, datë 28.7.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës”, të ndryshuar (ligji nr. 9121), për moslejimin e abuzimit me pozitën dominuese në treg të ndërmarrjes nëpërmjet vendosjes, në mënyrë të drejtpërdrejtë ose të tërthortë, të çmimeve të padrejta të shitjes apo e kushteve të tjera të tregtimit;

c) kërkesave të ligjit nr. 9902, datë 17.4.2008 “Për mbrojtjen e konsumatorëve”, të ndryshuar (ligji nr. 9902);

d) orientimin drejt mbulimit të kostove O&M pasi aktualisht shoqëria bën pjesë në grupin e shoqërive që tentojnë mbulimin e këtyre kostove;

e) tarifat e propozuara nga operatori të jenë në përputhje të plotë me parimin ligjor rregullator mbi përballueshmërinë, sipas të cilit tarifat duhet të jenë të përballueshme;

f) tarifat e propozuara nuk sjellin për pasojë efekte negative në mjedis nga veprimtaria e operatorit në zonën e shërbimit që ato do të aplikohen;

g) propozimin për ndryshimin e tarifave nga shoqëria, ERRU-ja e gjen të justifikuar, por jo në nivelin e propozuar.

7. ERRU-ja, në bazë të analizës, verifikimeve dhe komunikimit me stafin drejtues të shoqërisë i konsideron të arritshëm objektivat mbi treguesit e performancës dhe për këtë rekomandon:

a) detyrimisht për vitin 2020 shoqëria duhet të mbajë në kontabilitet kostot sipas shërbimit për shpenzimet direkte justifikuar me dokumentet justifikuese;

b) të evidentojë klientët problematikë, të ndjekë hapat ligjorë për arkëtimin e tyre dhe më pas në bashkëpunim me ekspertin auditues të llogarive, të llogarisë provizionimin e tyre të përvitshëm brenda mundësive reale të shoqërisë;

c) të gjejë mundësinë për të kryer investime për zëvendësimin e tubacionit të transmetimit, i cili jo vetëm është i amortizuar, por ka dhe prezencë të madhe lidhjesh të paligjshme;



d) të aktivizojë task-forcën për gjetjen dhe eliminimin e të gjitha lidhjeve të paligjshme në rrjetin e transmetimit dhe të shpërndarjes;

e) të mbajë evidenca mbi defektet e ndodhura gjatë vitit në sistemin e furnizimit, të përllogaritë sasi të humbura të ujit para riparimit dhe gjatë riparimit të tyre;

f) të mbajë nën kontroll të gjithë sistemin e furnizimit për të reaguar në kohën e duhur ndaj defekteve për të minimizuar humbjet nga rrjedhjet;

g) të angazhojë stafin për vlerësimin sa më real të çdo komponenti që përbën bilancin e ujit, si dhe të hartojë planin e veprimeve për reduktimin e tyre;

h) krahas përmirësimit të nivelit të treguesit financiar “Mbulimi i kostove O&M” drejt 100%, por edhe treguesve të tjerë, nevoja e riaplikimit për nivel të ri tarifor në një periudhë sa më të shpejtë, është e domosdoshme;

i) në aplikimin e radhës shoqëria të jetë korrekt në saktësinë e informacionit, si dhe në plotësimin e Modelit të Aplikimit pasi ERRU-ja nuk do të konsiderojë aplikime me mungesa duke i refuzuar.

Komisioni Kombëtar Rregullator, pasi vlerësoi tarifën e propozuar nga operatori mbi bazën e

Metodologjisë, të miratuar me vendim nr. 42, datë 9.12.2015 “Për miratimin e metodologjisë për vendosjen e tarifave për shërbimin e furnizimit me ujë dhe largim e përpunimin e ujërave të ndotura” si dhe akteve të tjera rregullatore që lidhen me të, arrin në konkluzionin se tarifën e propozuar sipas analizës së kryer janë të bazuara dhe në zbatim të kriterëve ligjore referuese lidhur me kostot e pranueshme dhe të justifikuara, si dhe përballeshmërinë, nuk janë të padrejta dhe të vendosura në kushtet e abuzimit me pozitën dominuese në treg të operatorit ekonomik në kuptim të ligjit nr. 9121, “Për mbrojtjen e konkurrencës”, të ndryshuar, dhe ligjin nr. 9902 “Për mbrojtjen e konsumatorëve”, për gjithë sa më sipër, në zbatim të neneve 13, 14 dhe 22, të ligjit nr. 8102, datë 28.3.1996 “Për kuadrin rregullator të sektorit të furnizimit me ujë dhe largimit e përpunimit të ujërave të ndotura”, i ndryshuar,

VENDOSI:

1. Miratimin e tarifave për shoqërinë Ujësjellës-Kanalizime Krujë, si më poshtë:

Kategoria	Tarifat sipas vendimit në zonën e shërbimit
Tarifë volumetrike për furnizimin me ujë	Lekë/m³
Konsumatorë familjarë	35
Konsumatorë publikë	80
Konsumatorë privatë	100
Tarifë volumetrike për KUN-in	Lekë/m³
Konsumatorë familjarë	8
Konsumatorë publikë	12
Konsumatorë privatë	12
Tarifë fikse	Lekë/muaj/lidhje
Konsumatorë familjarë	100
Konsumatorë publikë	200
Konsumatorë privatë	200

2. Objektivat e treguesve kryesorë të performancës të vitit 2020 për shoqërinë UK Krujë, të jenë:

Treguesit e performancës	Njësia e matjes	Niveli i objektivit të përcaktuar nga ERRU-ja
Mbulimi i kostove O&M	%	74.2
Uji pa të ardhura	%	52
Niveli i matjes	%	88
Vazhdimësia e furnizimit me ujë	orë/ditë	8
Eficienca e stafit	staf/1000 lidhje	5.5
Mbulimi me ujë	%	42.5
Mbulimi me KUN-in	%	25.7
Norma e arkëtimit korente	%	77



3. Pagesa rregullatore vjetore për shoqërinë Ujësjellës-Kanalizime Krujë sh.a. do të jetë 0.6% e të ardhurave vjetore të parashikuara nga aktiviteti.

4. Lidhjen e kontratës me UK Krujë, brenda 30 ditëve nga data e njoftimit sipas pikës 4, të nenit 22, të ligjit nr. 8102.

5. Vendimi nr. 13, datë 30.5.2007 “Për miratimin e tarifave të ujit për konsum publik për sh.a. Ujësjellës Krujë”, shfuqizohet.

6. Ky vendim hyn në fuqi më datë 1.12.2019 dhe është i vlefshëm deri në miratimin e tarifave të reja.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETAR
Ndrichim Shani

VENDIM
Nr. 53, datë 28.10.2019

PËR MIRATIMIN E TARIFAVE TË
SHËRBIMIT TË FURNIZIMIT ME UJË
DHE LARGIMIN E UJËRAVE TË
NDOTURA PËR SHOQËRINË
UJËSJELLËS-KANALIZIME
HIMARË SHA

Në mbështetje të neneve 13, 14, 21 dhe 22, të ligjit nr. 8102, datë 28.3.1996 “Për kuadrin rregullator të sektorit të furnizimit me ujë dhe largimit e përpunimit të ujërave të ndotura”, i ndryshuar (ligji nr. 8102), vendimit të Komisionit Kombëtar Rregullator nr. 39, datë 9.12.2015 “Për miratimin e politikës tarifore për shërbimin e furnizimit me ujë dhe largimit e përpunimit të ujërave të ndotura” (vendimi nr. 39), vendimit të Komisionit Kombëtar Rregullator nr. 40, datë 9.12.2015 “Për miratimin e dokumentacionit mbështetës për miratimin e tarifave për shërbimin e furnizimit me ujë, largimin e përpunimin e ujërave të ndotura” (vendimi nr. 40), vendimit të Komisionit Kombëtar Rregullator nr. 41, datë 9.12.2015 “Për miratimin e procesit të miratimit të tarifave për shërbimin e furnizimit me ujë, largimin e përpunimin e ujërave të ndotura” (vendimi nr. 41), vendimit të Komisionit Kombëtar Rregullator nr. 42, datë 9.12.2015 “Për miratimin e metodologjisë për vendosjen e tarifave për

shërbimin e furnizimit me ujë dhe largim e përpunimin e ujërave të ndotura” (vendimi nr. 42),

Komisioni Kombëtar Rregullator,

në mbledhjen e datës 28.10.2019 pasi shqyrtoi dokumentacionin e paraqitur nga Drejtoria Tekniko-Ekonomike, mbi kërkesën e Ujësjellës-Kanalizime Himarë sh.a., për miratimin e tarifave të shërbimit të furnizimit me ujë dhe kanalizime,

VËREN SE:

1. Shoqëria “Ujësjellës-Kanalizime Himarë” (UK Himarë), me shkresën nr. 80 prot., datë 5.7.2018 “Kërkesë për nivel të ri tarife për shërbimin e furnizimit me ujë të pijshëm dhe kanalizime” ka paraqitur kërkesën pranë Entit Rregullator të Sektorit të Furnizimit me Ujë dhe Largimit e Përpunimit të Ujërave të Ndotura (ERRU), për rritjen e tarifave në zonën e shërbimit për të tria kategoritë e konsumatorëve, të shoqëruar me dokumentacionin sipas përcaktimeve të parashikuara në ligjin nr. 8102 dhe në vendimin nr. 40.

2. Komisioni Kombëtar Rregullator (KKRR), pasi e gjeti paraqitjen e kërkesës për vendosjen e tarifave të shërbimit të furnizimit me ujë dhe largimin e ujërave të ndotura dhe tarifë fikse të shoqërisë UK Himarë, në përputhje me përcaktimet dhe procedurën e parashikuar në vendimin nr. 40, me vendimin nr. 76, datë 6.11.2018, vendosi fillimin e procedurës për shqyrtimin e aplikimit për propozimin e bërë nga UK Himarë për nivelin e ri tarifor për shërbimet UK për të gjithë zonën e riorganizuar të shërbimit në zbatim të VKM-së nr. 63, datë 27.1.2016 “Për riorganizimin e operatorëve që ofrojnë shërbimin e furnizimit me ujë, grumbullimin, largimin dhe trajtimin e ujërave të ndotura”.

3. Ujësjellës-Kanalizime Himarë ka paraqitur dokumentacionin e aplikimit për miratimin e tarifave pranë ERRU-së, me shkresën nr. 80 prot., datë 5.7.2018 “Kërkesë për nivel të ri tarife për shërbimin e furnizimit me ujë të pijshëm dhe kanalizime”, për të tria kategoritë e konsumatorëve sipas tabelës së mëposhtme:



Tabela me tarifat aktuale dhe të propozuara nga shoqëria sipas kategorisë së konsumatorëve

Kategoritë e konsumatorëve	Tarifat Viti 2017		Tarifat Viti 2018	Tarifat e propozuara	Ndryshimi	
	Zona e shërbimit		Zona e shërbimit	Zona e riorganizuar		
A. Tarifë volumetrike për furnizimin me ujë	Me rënie të lirë	Me ngritje mekanike	Lekë/m ³	Lekë/m ³	Lekë/m ³	Lekë/m ³
	Lekë/m ³	Lekë/m ³				
1. Konsumatorë familjarë	40	50	60	60	20	10
2. Konsumatorë publikë	40	50	100	100	60	50
3. Konsumatorë privatë	90	100/150	120	120	30	+20/-30
B. Tarifë volumetrike për KUN-in	Lekë/m ³	Lekë/m ³	Lekë/m ³	Lekë/m ³	Lekë/m ³	Lekë/m ³
1. Konsumatorë familjarë	20	30	30	30	10	0
2. Konsumatorë publikë	20	30	50	50	30	20
3. Konsumatorë privatë	60		50	50	10	
C. Tarifë fikse UK	Lekë/muaj / lidhje	Lekë/muaj/lidhje	Lekë/muaj/lidhje	Lekë/muaj / lidhje	Lekë/muaj/lidhje	Lekë/muaj/lidhje
1. Konsumatorë familjarë	100		200	200	100	
2. Konsumatorë publikë	100		300	300	200	
3. Konsumatorë privatë	200		300	300	100	

Me vendim nr. 144, datë 23.2.2018, të Këshillit Bashkiak, shoqëria UK Himarë, në vitin 2018, ka aplikuar tarifa për shërbimin e furnizimit me ujë, por edhe atë të kanalizimeve të njëjta me tarifat që propozon për t'u miratuar në vitin e ardhshëm nga ERRU-ja, gjë e cila vërehet edhe nga tabela e mësipërme.

Shoqëria UK Himarë aplikon për herë të parë për miratimin e nivelit tarifor të shërbimit UK dhe se tarifat që aplikohen aktualisht janë të pamiratura nga ERRU-ja.

Ligjërish, shoqëria duhet të aplikojë tarifat e miratuara nga ERRU-ja, sipas vendimit nr. 29, datë 13.10.2004 “Për miratimin e tarifave për konsum publik të sh.a. Ujësjellës Himarë”.

4. Referuar kërkesës dhe dokumentacionit shoqërues, rezulton se treguesit e arritur të performancës për vitin 2018 dhe objektivat e propozuar nga shoqëria UK Himarë, për vitin 2019, janë sipas tabelës së mëposhtme:

Tabela me treguesit kryesorë të performancës për vitet 2018–2019

Treguesit e performancës	Njësia e matjes	Treguesit e performancës sipas shoqërisë	
		Viti 2018 realizimi	Viti 2019 parashikimi
Mbulimi i kostove direkte të O&M	%	98	109
Mbulimi i kostove totale	%	79	87
Uji pa të ardhura	%	74	67
Mbulimi me ujë	%	91	91
Mbulimi me KUN	%	21	19.5
Niveli i matjes	%	90	86
Norma e arkëtimit korrente	%	78	80
Vazhdimësia e furnizimit me ujë (vetëm për njësitë ku shërbehet)	orë/ditë	20	20
Efienca e stafit	staf/1000 lidhje UK	6.4	6



Në Metodologjinë e Vendosjes së tarifave për shërbimin e furnizimit me ujë dhe largimin e përpunimit të ujërave të ndotura, miratuar me vendimin e KKRR-së nr. 42, datë 9.12.2015, në nenin 16 të saj “Vlerësimi i propozimit për ndryshim tarife – periudha tranzitore”, citohet: “Për propozimin e parë për ndryshimin e tarifës, brenda periudhës tranzitore, për rastet kur shtohet një zonë e re si pjesë e zonës së shërbimit të operatorit, sipas kësaj metodologjie do të bëhet vetëm analiza e kostos. Më tej, ERRU-ja do të përcaktojë një grup treguesish bazë performance për çdo operatorë, të cilët do të shërbejnë si referencë dhe do të vlerësohen gjatë ndryshimeve të tarifave për periudhat në vazhdim”.

Nisur nga sa më sipër, UK Himarë është një shoqëri e re e riorganizuar, që aplikon për herë të parë sipas kësaj Metodologjie. Shoqëria UK Himarë bën pjesë në grupin e shoqërive që tentojnë të mbulojnë mbi nivelin 100% kostot e operim dhe mirëmbajtjes përmirësimi i këtij treguesi është objektivi kryesor i shoqërisë për vitin 2019.

Nevoja e ndryshimit të tarifave nga ana e UK Himarë, me qëllim gjenerimin e të ardhurave shtesë argumentohet si më poshtë, të cilat vlerësohen nga ERRU-ja:

a) përmbushja e detyrimit ligjor për të pasur tarifa të miratuara nga ERRU-ja për shërbimin e furnizimit me ujë të pijshëm dhe largimin e ujërave të ndotura;

b) aplikimi i tarifave të unifikuara për të gjithë zonën e shërbimit të shoqërisë;

c) përmirësimin e nivelit aktual të mbulimit të kostove O&M, si dhe të kostove totale;

d) përmirësimin e nivelit të lartë të humbjeve nga 74% në 67% nëpërmjet një plani të detajuar të ndarë në faza, për reduktimin e humbjeve, të cilat do të ndikojnë drejtpërsëdrejti në përmirësimin e performancës financiare. Ky planveprimi kryesisht konsiston në evidentimin dhe në shkëputjen e lidhjeve të paligjshme të ujit, duke ndikuar kështu në reduktimin e humbjeve administrative;

e) vendosja e ujëmatësve në prodhim për të vlerësuar saktë sasinë e ujit që prodhohet dhe sasinë e ujit të pafaturuar;

f) subvencionimi nga ana e qeverisë ka qenë në shumën të pamjaftueshme, referuar nevojave të shoqërisë, të cilat kanë shkruar për shlyerjen e

kryesisht të detyrimeve të prapambetura ndaj OSHEE-së për energjinë elektrike.

5. ERRU-ja, gjatë procesit të analizës teknike ekonomike sipas metodologjisë së llogaritjes së tarifave të përcaktuar në vendimin nr. 42, ka kërkuar nga UK Himarë informacion shtesë, si dhe verifikim të saktësisë së të dhënave, të cilat janë vënë në dispozicion.

6. ERRU-ja, në vlerësimin e tarifave të propozuara dhe treguesve të performancës, si dhe në analizën ekonomike-financiare, ka marrë në konsideratë përmbushjen nga ana e UK Himarë, të:

a) kërkesave të ligjit nr. 8102, si dhe të akteve nënligjore dhe kuadrit rregullator në fuqi, në mënyrë të veçantë mbrojtjen e konsumatorëve nga çmimet monopol;

b) kërkesave të ligjit nr. 9121, datë 28.7.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës”, të ndryshuar (ligji nr. 9121), për moslejimin e abuzimit me pozitën dominuese në treg të ndërmarrjes nëpërmjet vendosjes, në mënyrë të drejtpërdrejtë ose të tërthortë, të çmimeve të padrejta të shitjes apo e kushteve të tjera të tregtimit;

c) kërkesave të ligjit nr. 9902, datë 17.4.2008 “Për mbrojtjen e konsumatorëve”, të ndryshuar (ligji nr. 9902);

d) orientimin drejt mbulimit të kostove O&M në nivelin 109% pasi aktualisht shoqëria bën pjesë në grupin e shoqërive që mbulon 98% të këtyre kostove;

e) tarifat e propozuara nga operatori të jenë në përputhje të plotë me parimin ligjor rregullator mbi përballueshmërinë, sipas të cilit tarifat duhet të jenë të përballueshme;

f) tarifat e propozuara nuk sjellin për pasojë efekte negative në mjedis nga veprimtaria e operatorit në zonën e shërbimit që ato do të aplikohen;

g) propozimin për ndryshimin e tarifave nga shoqëria, ERRU-ja e gjen të justifikuar, por jo në nivelin e propozuar për sa u përket tarifave volumetrike për shërbimin e furnizimit me ujë të pijshëm, si dhe tarifën fikse të shërbimit.

7. ERRU-ja, në bazë të analizës, verifikimeve dhe komunikimit me stafin drejtues të shoqërisë i konsideron të arritshëm objektivat mbi treguesit e performancës dhe për këtë rekomandon:

a) duhet të saktësojë të dhënat, të zbatojë Standardet e Kontabilitetit me qëllim pasqyrimin real të situatës financiare të shoqërisë;



b) shoqëria duhet të analizojë historikun e krijimit të debisë nga mos pagimi i faturave të shërbimeve UK, të evidentojë klientët problematik, të hartojë një plan masash të detajuar për vjeljen e debive të prapambetura;

c) shoqëria, detyruesisht, në vitin e ardhshëm duhet të mbajë në kontabilitet të ndara me qendra kostojë shërbimet që ofrojnë ujë dhe kanalizime, me qëllim që dhe tarifat të orientohen drejt kostove;

d) menaxhimi dhe shlyerja në kohë e detyrimeve ndaj furnitorëve (kryesisht OSHEE-ja për energjinë elektrike), me qëllim reduktimin e kostove shtesë që kanë të bëjnë me kamatëvonesat, duke përfituar edhe nga subvencionet e alokuara nga qeveria;

e) shoqëria duhet të evidentojë gjendjen e aseteve të ndara për ujin dhe kanalizimet, amortizimin e tyre, si dhe grupimin sipas moshës së aseteve, me qëllim marrjen e masave për rinovimin me qëllim krijim e një Plani për Menaxhimin të Aseteve;

f) të pajiset me matës të mëdhenj në të gjitha pikat e prodhimit të ujit, si dhe në pikat kryesore të rrjetit, si dhe zbatimi i një strategjie të leximit dhe regjistrimit rigoroz të burimit, çdo ditë, çdo muaj;

g) për të hartuar bilancin e ujit sa më real, në të gjithë nënçerërat e tij, duhet të angazhojë stafin që çdo komponent që përbën këtë bilanc të jetë i monitoruar gjatë gjithë vitit, të mbajë evidenca mbi sasitë e ujit që nuk maten, mbi sasitë e ujit që falen etj.;

h) të organizojë taks-forcën e re për të vazhduar aksionin për gjetjen dhe eliminimin e të gjitha

lidhjeve të paligjshme në rrjetin e transmetimit dhe të shpërndarjes. Të mbajë nën kontroll të gjithë sistemin e furnizimit për të reaguar në kohën e duhur ndaj riparimit të defekteve, për të minimizuar sa më shumë humbjet nga rrjedhjet.

Komisioni Kombëtar Rregullator, pasi vlerësoi tarifat e propozuara nga operatori mbi bazën e Metodologjisë, të miratuar me vendim nr. 42, datë 9.12.2015 “Për miratimin e metodologjisë për vendosjen e tarifave për shërbimin e furnizimit me ujë dhe largim e përpunimit të ujërave të ndotura”, si dhe akteve të tjera rregullatore që lidhen me të, arrin në konkluzionin se tarifat e propozuara sipas analizës së kryer janë të bazuara dhe në zbatim të kriterëve ligjore referuese lidhur me kostot e pranueshme dhe të justifikuar, si dhe përballueshmërinë, nuk janë të padrejta dhe të vendosura në kushtet e abuzimit me pozitën dominuese në treg të operatorit ekonomik në kuptim të ligjit nr. 9121, “Për mbrojtjen e konkurrencës”, të ndryshuar, dhe ligjin nr. 9902 “Për mbrojtjen e konsumatorëve”, për gjithë sa më sipër, në zbatim të neneve 13, 14 dhe 22, të ligjit nr. 8102, datë 28.3.1996 “Për kuadrin rregullator të sektorit të furnizimit me ujë dhe largimit e përpunimit të ujërave të ndotura”, i ndryshuar,

VENDOSI:

1. Miratimin e tarifave për shoqërinë Ujësjellës-Kanalizime Himarë, si më poshtë:

Kategoria	Tarifat sipas vendimit në zonën e shërbimit
Tarifë volumetrike për furnizimin me ujë	Lekë/m³
Konsumatorë familjarë	55
Konsumatorë publikë	100
Konsumatorë privatë	100
Tarifë volumetrike për KUN-in	Lekë/m³
Konsumatorë familjarë	30
Konsumatorë publikë	50
Konsumatorë privatë	50
Tarifë fikse	Lekë/muaj/lidhje
Konsumatorë familjarë	200
Konsumatorë publikë	200
Konsumatorë privatë	300



2. Objektivat e treguesve kryesorë të performancës të vitit 2020 për shoqërinë UK Himarë, të jenë:

Treguesit e performancës	Njësia e matjes	Niveli i objektivit për vitin 2020 të përcaktuar nga ERRU-ja
Mbulimi i kostove O&M	%	113
Uji pa të ardhura	%	67
Niveli i matjes	%	90
Vazhdimësia e furnizimit me ujë	orë/ditë	21
Eficienca e stafit	staf/1000 lidhje	6
Mbulimi me ujë	%	91
Mbulimi me KUN	%	20
Norma e arkëtimit korente	%	80

3. Pagesa rregullatore vjetore për shoqërinë Ujësjellës-Kanalizime Himarë sh.a. do të jetë 0.6% e të ardhurave vjetore të parashikuara nga aktiviteti.

4. Lidhjen e kontratës me UK Himarë brenda 30 ditëve nga data e njoftimit sipas pikës 4, të nenit 22, të ligjit nr. 8102.

5. Ky vendim hyn në fuqi më datë 1.12.2019 dhe është i vlefshëm deri në miratimin e tarifave të reja.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETAR
Ndriçim Shani

VENDIM Nr. 54, datë 28.10.2019

PËR NJË NDRYSHIM NË VENDIMIN E KOMISIONIT KOMBËTAR RREGULLATOR NR. 47, DATË 13.6.2018, “PËR LICENCIMIN E SHA UJËSJELLËS- KANALIZIME DIBËR”, I NDRYSHUAR

Në mbështetje të neneve 13, 14, 16 dhe 17, të ligjit nr. 8102, datë 28.3.1996 “Për kuadrin rregullator të sektorit të furnizimit me ujë dhe largimit e përpunimit të ujërave të ndotura”, i ndryshuar (ligji nr. 8102), VKM-së nr. 958, datë 6.5.2009 “Për miratimin e kategorive të licencimit dhe të procedurave për aplikim për licencë” (VKM nr. 958), si dhe vendimit të Komisionit Kombëtar Rregullator nr. 29, datë 8.12.2009 “Për procedurat e dhënies dhe rinovimit të licencave profesionale për subjektet juridike e fizike që ushtrojnë veprimtari në sektorin e furnizimit me ujë dhe largimit e

përpunimit të ujërave të ndotura”, e ndryshuar (rregullorja e licencimit),

Komisioni Kombëtar Rregullator,

në mbledhjen e datës 28.10.2019, pasi shqyrtoi çështjen me objekt: “Mbi miratimin e projekt vendimit ‘Për një ndryshim në vendimin e Komisionit Kombëtar Rregullator nr. 47, datë 13.6.2018, ‘Për licencimin e sh.a. Ujësjellës-Kanalizime Dibër’”, i ndryshuar,

VËREN SE:

1. Shoqëria Ujësjellës-Kanalizime Dibër (UK Dibër), me shkresën nr. 665 prot., datë 30.9.2019, me lëndë “Përcjellje e dokumenteve të nevojshëm për ndryshimin e drejtuesit teknik” ka paraqitur pranë Entit Rregullator të Sektorit të Furnizimit me Ujë dhe Largimit e Përpunimit të Ujërave të Ndotura (ERRU) kërkesën për rinovim të licencës për efekt të ndryshimit të drejtuesit teknik të shoqëruar me dokumentacionin sipas përcaktimeve të parashikuara në VKM-në nr. 958 dhe në rregulloren e licencimit.

2. Komisioni Kombëtar Rregullator (KKRR) e gjeti paraqitjen e kërkesës së UK Dibër për rinovim licence për efekt të ndryshimit të drejtuesit teknik në konformitet me kriteret dhe procedurën e parashikuar në VKM nr. 958 dhe në rregulloren e licencimit.

3. KKRR-ja ka licencuar shoqërinë UK Dibër me vendimin nr. 47, datë 13.6.2018, “Për licencimin e sh. a. Ujësjellës-Kanalizime Dibër”, i ndryshuar, me një afat 4-vjeçar, ku shoqëria



autorizohet të ofrojë shërbimin e grumbullimit dhe shpërndarjes së ujit për konsum publik.

4. Drejtuesi teknik i shoqërisë UK Dibër sh.a., z. Elvis Manga, zotëron diplomë Bachelor në “Inxhinieri ndërtimi”, marrë në tetor 2017.

5. ERRU-ja, në vlerësimin e kërkesës për ndryshimin e licencës për efekt të ndryshimit të drejtuesit teknik ka marrë në konsideratë përmbushjen nga ana e UK Dibër sh.a. të kërkesave të ligjit nr. 8102, të VKM-së nr. 958 dhe rregullores së licencimit, në mënyrë të veçantë sa i takon garantimit që i licencuari të veprojë në përputhje me kushtet e licencës së tij dhe të mbrojë interesat e konsumatorëve në lidhje me cilësinë, eficiencën, vazhdueshmërinë dhe garancinë e shërbimit.

Për gjithë sa më sipër, Komisioni Kombëtar Rregullator, pasi arriti në përfundimin se aplikimi i UK Dibër është i bazuar ligjërisht dhe plotëson kërkesat ligjore të parashikuara në kuadrin rregullator në fuqi,

VENDOSI:

1. Në pikën 1, të vendimit të KKRR-së nr. 47, datë 13.6.2018 “Për licencimin e sh.a. Ujësjetllës-Kanalizime Dibër”, i ndryshuar, bëhen këto ndryshime:

“Drejtues teknik z. Elvis Manga”.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Ky vendim publikohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETAR
Ndriçim Shani

VENDIM Nr. 55, datë 28.10.2019

PËR LICENCIMIN E SHOQËRISË UJËSJELLËS-KANALIZIME ELBASAN SHA

Në mbështetje të neneve 13, 14, 15, 16 dhe 17, të ligjit nr. 8102, datë 28.3.1996 “Për kuadrin rregullator të sektorit të furnizimit me ujë dhe largimit e përpunimit të ujërave të ndotura”, i ndryshuar (ligji nr. 8102), VKM-së nr. 958, datë 6.5.2009 “Për miratimin e kategorive të licencimit dhe të procedurave për aplikim për licence” (VKM nr. 958), si dhe vendimit të Komisionit Kombëtar

Rregullator nr. 29, datë 8.12.2009 “Për procedurat e dhënies dhe rinovimit të licencave profesionale për subjektet juridike e fizike që ushtrojnë veprimtari në sektorin e furnizimit me ujë dhe largimit e përpunimit të ujërave të ndotura”, i ndryshuar (rregullorja e licencimit),

Komisioni Kombëtar Rregullator,

në mbledhjen e datës 28.10.2019, pasi shqyrtoi çështjen me objekt: “Mbi miratimin e projekt vendimit ‘Për licencimin e shoqërisë Ujësjetllës-Kanalizime Elbasan sh.a.’”,

VËREN SE:

1. Shoqëria Ujësjetllës-Kanalizime Elbasan (UK Elbasan), me shkresën nr. 1764 prot., datë 30.7.2019, ka paraqitur pranë Entit Rregullator të Sektorit të Furnizimit me Ujë dhe Largimit e Përpunimit të Ujërave të Ndotura (ERRU) kërkesën për licencim për shkak të mbarimit të afatit dhe ndryshimit të drejtuesit ligjor.

2. Komisioni Kombëtar Rregullator (KKRR) e gjeti paraqitjen e kërkesës për licencim për shkak të mbarimit të afatit dhe ndryshimit të drejtuesit ligjor të UK Elbasan në konformitet me kriteret dhe procedurën e parashikuar në VKM-në nr. 958 dhe në rregulloren e licencimit.

3. Referuar kërkesës dhe dokumentacionit shoqërues, rezulton:

a) shoqëria UK Elbasan ofron shërbimin e furnizimit me ujë dhe largimit të ujërave të ndotura për 157 349 banorë në Bashkinë Elbasan;

b) drejtuesi teknik i shoqërisë, z. Julian Doçi, zotëron diplomë master në “Inxhinieri hidroteknike”, marrë në mars të vitit 2011 dhe ka 8 vite përvojë në profesion.

4. ERRU-ja, në vlerësimin e kërkesës për licencim për shkak të mbarimit të afatit dhe ndryshimit të drejtuesit ligjor ka marrë në konsideratë përmbushjen nga ana e UK Elbasan, të:

a) kërkesave të ligjit nr. 8102, si dhe kuadrin rregullator në fuqi, në mënyrë të veçantë plotësimin e kushteve si aftësi teknike-profesionale, aftësi financiare të nevojshme për të përmbushur funksionet dhe për të plotësuar kushtet e licencës, përvojën në sektorin e ujësjetllësve dhe kanalizimeve të mjaftueshme për të marrë përsipër



detyrimet që ka licenca, si dhe mbrojtjen e interesave të konsumatorëve në lidhje me cilësinë, eficiencën, vazhdueshmërinë dhe garancinë e shërbimit;

b) kërkesave të ligjit nr. 9121, datë 28.7.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës”, të ndryshuar (ligji nr. 9121), për moslejimin e abuzimit me pozitën dominuese në treg të ndërmarrjes veçanërisht në lidhje me kufizimin e tregjeve.

5. ERRU-ja, në bazë të vlerësimit dhe verifikimeve të kërkesës së shoqërisë UK Elbasan, rekomandon:

- Shoqëria UK Elbasan duhet të aplikojë pranë ERRU-së, për miratimin e tarifave për shërbimin e furnizimit me ujë dhe largimit të ujërave të ndotura, me një strukturë të re tarifore.

Për gjithë sa më sipër, Komisioni Kombëtar Rregullator, pasi arriti në përfundimin se kërkesa e UK Elbasan është e bazuar ligjërisht dhe plotëson kërkesat ligjore të parashikuara në kuadrin rregullator në fuqi,

VENDOSI:

1. Licencimin e shoqërisë Ujësjiellës-Kanalizime UK Elbasan sh.a., me NUIS L43121201L në kategoritë:

a) kategoria A – për grumbullimin dhe shpërndarjen e ujit për konsum publik;

b) kategoria C – për largimin e ujërave të ndotura.

2. Shoqëria Ujësjiellës-Kanalizime UK Elbasan sh.a. autorizohet të kryejë veprimtaritë e licencuara me:

a) drejtues ligjor – z. Luan Dervishi;

b) drejtues teknik – z. Julian Doçi.

3. Zona e shërbimit të shoqërisë Ujësjiellës-Kanalizime UK Elbasan sh.a., është:

Bashkia Elbasan.

4. Kjo licencë është e vlefshme për një periudhë 4 vjeçare.

5. Drejtuesi ligjor i shoqërisë Ujësjiellës-Kanalizime UK Elbasan sh.a. detyrohet të nënshkruajë kushtet e licencës, brenda 10 ditëve nga data e njoftimit.

6. Ngarkohet Drejtoria Tekniko-Ekonomike të njoftojë shoqërinë Ujësjiellës-Kanalizime UK Elbasan sh.a. për marrjen e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Ky vendim publikohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETAR
Ndriçim Shani

VENDIM

Nr. 56, datë 28.10.2019

PËR LICENCIMIN PËR HERË TË PARË TË SHOQËRISË UJËSJIELLËS- KANALIZIME KËLCYRË SHA

Në mbështetje të neneve 13, 14, 15, 16 dhe 17, të ligjit nr. 8102, datë 28.3.1996 “Për kuadrin rregullator të sektorit të furnizimit me ujë dhe largimit e përpunimit të ujërave të ndotura”, i ndryshuar (ligji nr. 8102), VKM-së nr. 958, datë 6.5.2009 “Për miratimin e kategorive të licencimit dhe të procedurave për aplikim për licence” (VKM nr.958), si dhe vendimit të Komisionit Kombëtar Rregullator nr. 29, datë 8.12.2009 “Për procedurat e dhënies dhe rinovimit të licencave profesionale për subjektet juridike e fizike që ushtrojnë veprimtari në sektorin e furnizimit me ujë dhe largimit e përpunimit të ujërave të ndotura”, i ndryshuar (rregullorja e licencimit),

Komisioni Kombëtar Rregullator,

në mbledhjen e datës 28.10.2019, pasi shqyrtoi çështjen me objekt: “Mbi miratimin e projekt vendimit ‘Për licencimin për herë të parë të shoqërisë Ujësjiellës-Kanalizime Këlcyre sh.a.’”,

VËREN SE:

1. Shoqëria Ujësjiellës-Kanalizime Këlcyre (UK Këlcyre), me shkresën nr. 26 prot. datë 14.11.2017, me lëndë “Kërkesë për licencim”, shkresën nr. 50 prot., datë 10.8.2018 “Shkresë për plotësim dokumentacioni”, shkresën nr. 27 prot., datë 31.7.2019 “Shkresë për plotësim dokumentacioni”, shkresën nr. 30 prot., datë 30.9.2019 “Shkresë për plotësim dokumentacioni”, ka paraqitur pranë Entit Rregullator të Sektorit të Furnizimit me Ujë dhe Largimit e Përpunimit të Ujërave të Ndotura (ERRU) kërkesën për licencim për herë të parë.

2. Komisioni Kombëtar Rregullator (KKRR) e gjeti paraqitjen e kërkesës për licencim për herë të



parë për UK Këlcyrë në konformitet me kriteret dhe procedurën e parashikuar në VKM-në nr. 958 dhe në rregulloren e licencimit.

3. Referuar kërkesës dhe dokumentacionit shoqërues, rezulton:

a) Shoqëria UK Këlcyrë ofron shërbimin e furnizimit me ujë për 5 754 banorë në Bashkinë Këlcyrë si më poshtë:

Zona e shërbimit me furnizim me ujë nga shoqëria UK Këlcyrë:

Nr.	Njësitë administrative të Bashkisë Këlcyrë	Popullsia në juridiksion	Popullsia e shërbyer
1	Këlcyrë	5 089	2 516
2	Deshnicë	2 600	1 204
3	Sukë+Ballaban	4 700	2 034
	TOTALI	12 389 banorë	5 754 banorë

b) Drejtuese teknike e shoqërisë, znj. Aldisa Durdaj, mban titullin master profesional në “Inxhinieri mjedisi”, datë 18.10.2016, pranë Universitetit Politeknik Tiranë.

4. ERRU-ja, në vlerësimin e kërkesës për licencim për herë të parë ka marrë në konsideratë përmbushjen nga ana e UK Këlcyrë, të:

a) kërkesave të ligjit nr. 8102, si dhe kuadrit rregullator në fuqi, në mënyrë të veçantë plotësimin e kushteve si aftësi teknike-profesionale, aftësi financiare të nevojshme për të përmbushur funksionet dhe për të plotësuar kushtet e licencës, përvojën në sektorin e ujësjellësve dhe kanalizimeve të mjaftueshme për të marrë përsipër detyrimet që ka licenca, si dhe mbrojtjen e interesave të konsumatorëve në lidhje me cilësinë, eficiencën, vazhdueshmërinë dhe garancinë e shërbimit;

b) kërkesave të ligjit nr. 9121, datë 28.7.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës”, të ndryshuar (ligji nr. 9121) për moslejimin e abuzimit me pozitën dominuese në treg të ndërmarrjes veçanërisht në lidhje me kufizimin e tregjeve.

5. ERRU-ja, në bazë të vlerësimit dhe verifikimeve të kërkesës së shoqërisë UK Këlcyrë, rekomandon:

- Shoqëria UK Këlcyrë duhet të aplikojë pranë ERRU-së për miratimin e tarifave për shërbimin e furnizimit me ujë;

- Shoqëria UK Këlcyrë duhet të punojë në drejtim të zgjerimit të zonës së shërbimit në mënyrë që të gjithë banorët e Bashkisë Këlcyrë të marrin shërbimin e furnizimit me ujë dhe largimit të ujërave të ndotura nga kjo shoqëri me cilësi dhe brenda standardeve.

Për gjithë sa më sipër, Komisioni Kombëtar Rregullator, pasi arriti në përfundimin se kërkesa e UK Këlcyrë është e bazuar ligjërisht dhe plotëson

kërkesat ligjore të parashikuara në kuadrin rregullator në fuqi,

VENDOSI:

1. Licencimin e shoqërisë Ujësjellës-Kanalizime Këlcyrë sh.a., me NUIS K49225204A në kategoritë:

a) kategoria A – për grumbullimin dhe shpërndarjen e ujit për konsum publik.

2. Shoqëria Ujësjellës-Kanalizime Këlcyrë sh.a. autorizohet të kryejë veprimtaritë e licencuara me:

a) drejtues ligjor – Elidon Beqiri;

b) drejtuese teknike – Aldisa Durdaj.

3. Zona e shërbimit të shoqërisë Ujësjellës-Kanalizime Këlcyrë sh.a., është:

Bashkia Këlcyrë: Njësia Administrative Këlcyrë (pjesërisht);

Deshnicë (pjesërisht);

Sukë + Ballaban (pjesërisht).

4. Kjo licencë është e vlefshme për një periudhë 4-vjeçare.

5. Drejtuesi ligjor i shoqërisë Ujësjellës-Kanalizime Këlcyrë sh.a. detyrohet të nënshkruajë kushtet e licencës, brenda 10 ditëve nga data e njoftimit.

6. Ngarkohet Drejtoria Teknike-Ekonomike të njoftojë shoqërinë Ujësjellës-Kanalizime Këlcyrë sh.a., për marrjen e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Ky vendim publikohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETAR
Ndriçim Shani

**VENDIM****Nr. 57, datë 28.10.2019****PËR NJË NDRYSHIM NË VENDIMIN E
KOMISIONIT KOMBËTAR
RREGULLATOR NR. 6, DATË 3.2.2017,
“PËR LICENCIMIN E SHA UJËSJELLËS-
KANALIZIME GJIROKASTËR”**

Në mbështetje të neneve 13, 14, 16 dhe 17, të ligjit nr. 8102, datë 28.3.1996 “Për kuadrin rregullator të sektorit të furnizimit me ujë dhe largimit e përpunimit të ujërave të ndotura”, i ndryshuar (ligji nr. 8102), VKM-së nr. 958, datë 6.5.2009 “Për miratimin e kategorive të licencimit dhe të procedurave për aplikim për licencë” (VKM nr. 958), si dhe vendimit të Komisionit Kombëtar Rregullator nr. 29, datë 8.12.2009 “Për procedurat e dhënies dhe rinovimit të licencave profesionale për subjektet juridike e fizike që ushtrojnë veprimtari në sektorin e furnizimit me ujë dhe largimit e përpunimit të ujërave të ndotura”, i ndryshuar (rregullorja e licencimit),

Komisioni Kombëtar Rregullator,

në mbledhjen e datës 28.10.2019, pasi shqyrtoi çështjen me objekt: “Mbi miratimin e projekt vendimit ‘Për një ndryshim në vendimin e Komisionit Kombëtar nr. 6, datë 3.2.2017 ‘Për licencimin e sh.a Ujësjiellës-Kanalizime Gjirrokastër’”,

VËREN SE:

1. Shoqëria Ujësjiellës-Kanalizime Gjirrokastër (UK Gjirrokastër), me shkresën nr. 983 prot., datë 9.9.2019, me lëndë “Njoftim në lidhje me ndryshimin e drejtuesit ligjor të sh.a. Ujësjiellës-Kanalizime Gjirrokastër” ka paraqitur pranë Entit Rregullator të Sektorit të Furnizimit me Ujë dhe Largimit e Përpunimit të Ujërave të Ndotura (ERRU) kërkesën për rinovim të licencës për efekt të ndryshimit të drejtuesit ligjor, të shoqëruar me dokumentacionin sipas përcaktimeve të parashikuara në VKM-në nr. 958 dhe në rregulloren e licencimit.

2. Komisioni Kombëtar Rregullator (KKRR) e gjeti paraqitjen e kërkesës së UK Gjirrokastër për rinovim licence, për efekt të ndryshimit të drejtuesit

ligjor, në konformitet me kriteret dhe me procedurën e parashikuar në VKM-në nr. 958 dhe në rregulloren e licencimit.

3. KKRR-ja ka licencuar shoqërinë UK Gjirrokastër, me vendimin nr. 6, datë 3.2.2017 “Për licencimin e sh.a. Ujësjiellës-Kanalizime Gjirrokastër”, me një afat 4-vjeçar, ku shoqëria autorizohet të ofrojë shërbimin e grumbullimit dhe shpërndarjes së ujit për konsum publik, si dhe largimit të ujërave të ndotura.

4. Drejtuesi ligjor i shoqërisë UK Gjirrokastër sh.a. z. Gentian Llogo, ka mbaruar studimet e larta në “Ekonomi”, dega “Financë kontabilitet”, si dhe master për “Financë bankë”.

5. ERRU-ja, në vlerësimin e kërkesës për ndryshimin e licencës për efekt të ndryshimit të drejtuesit ligjor ka marrë në konsideratë përmbushjen nga ana e UK Gjirrokastër sh.a. të kërkesave të ligjit nr. 8102, të VKM-së nr. 958 dhe të rregullores së licencimit, në mënyrë të veçantë sa i takon garantimit që i licencuari të veprojë në përputhje me kushtet e licencës së tij dhe të mbrojë interesat e konsumatorëve në lidhje me cilësinë, eficiencën, vazhdueshmërinë dhe garancinë e shërbimit.

Për gjithë sa më sipër, Komisioni Kombëtar Rregullator, pasi arriti në përfundimin se aplikimi i UK Gjirrokastër është i bazuar ligjërisht dhe plotëson kërkesat ligjore të parashikuara në kuadrin rregullator në fuqi,

VENDOSI:

1. Në pikën 1, të vendimit të KKRR-së nr. 6, datë 3.2.2017 “Për licencimin e sh.a. Ujësjiellës-Kanalizime Gjirrokastër”, bëhen këto ndryshime:

“Drejtues ligjor z. Gentian Llogo”,

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Ky vendim publikohet në Fletoren Zyrtare.

**KRYETAR
Ndriçim Shani**

**NJOFTIM****Nr. 16979, datë 25.11.2019****MBI ADERIMIN E REPUBLIKËS SË
SHQIPËRISË NË NJË KONVENTË**

Republika e Shqipërisë ka aderuar në datën 8 nëntor 2019, në Konventën për Përpunimin e Farmakopesë Evropiane, Strasburg, 22.VII.1964, tekst i ndryshuar në përputhje me dispozitat e protokollit të Konventës (EST nr. 134). Kjo Konventë do të hyjë në fuqi për Shqipërinë në datën 9 shkurt 2020.

SEKRETAR I PËRGJITHSHËM
I MINISTRISË PËR EVROPËN
DHE PUNËT E JASHTME
Armand Skapi

	Formati 61x86/8
--	-----------------

Shtypshkronja e Qendrës së Botimeve Zyrtare
Tiranë, 2019

Adresa: Rr. “Nikolla Jorga”, Tiranë
Tel./fax: +355 4 24 27 004 Tel.: +355 4 24 27 006

Çmimi 224 lekë